-Më 1635 Frang Bardhi botoi veprën "Fjalor latinisht-shqip" prej 238 faqesh. Ky fjalor dëshmon se shqipja është e vjetër dhe e pavarur nga latinishtja.

Më 1685 Pjetër Bogdan ishkroi veprën "Çeta e profetëve". Bogdani ishte me origjinë nga Kosova, nga Hasi i Prizrenit.

Pas vdekjes së Skënderbeut, një pjesë e madhe e e shqiptarëve migruan në Itali, ku sot ata njihen si arbëreshët e Italisë. Vepra e parë letrare është "E mbësuame e krështërë" e autorit Lekë Matranga, e shkruar më 1592., kurse Jul Variboba , më 1762 shkroi veprën "Gjella e Shën Mërisë virgjër".

Mësuesi/ja u kërkon nxënësve të përgjigjen në pyetjet :

- Cili është dokumenti i parë i shkruar në gjuhën shqipe ?
- Kur u botua "Meshari" dhe kush ishte autorri?
- Ç'përbante pasthënia e këtij libri?
- Kur dhe nga kush është shkruar Doktrina e krështërë?
- Pse ka rëndësi :Fjalori Latinisht-shqip" i F.Bardhit?
- Cilët janë autorët dhe veprat e shkrimitarëve arbëreshë?



#### RQ Punë e pavarur

Në mënyrë të shkruar nxënësit i përgjigjen pyetjes:

Përse janë të rëndësishme dokumentet e lartpërmendura për gjuhën, kulturën dhe historinë e popullit tonë?

**LIDHJA ME FUSHAT E TJERA:**  
Histori

**VLERËSIMI:**  
Vlerësohen nxënësit për përfshirjen e tyre në diskutim dhe për saktësinë e përgjigjeve të dhëna.

**DETÝRË SHTËPIE :**  
**punë e diferençuar**

Fusha e kurrikulës- Gjuhë dhe komunikim Shkalla e Kurrikulës/3/Klasa : VII Lënda : Gjuhë shqipe	
Tema mësimore: <b>Dokumentet e para të shkrimit shqip</b> Njësia mësimore:Dokumentet e para të shkrimit shqip II	
<b>Materiale dhe mjete mësimore</b> Teksti mësimor <i>Gjuha shqipe</i> 7, fletore,harta e trojeve shqiptare, njoheritë e nnxënësit	<b>Metoda dhe teknika mësimore.</b> stuhi mendimi, leksion i përparuar, punë e pavarur
<b>Përdorimi i teknologjisë informative :</b>	
<b>Kontributi në kompetencat kryesore :</b>	
1 <b>Kompetenca komunikim dhe të shprehur -- Komunikues efektiv</b>	1,2,3,4,5,6,7,8
2 <b>Kompetenca të të menduarit -- Mendimtar kreativ dhe kritik</b>	1,2,3,4,5,6,7,8
3 <b>Kompetenca të të mësuarit për të nxënë- Nxënës i suksesshëm</b>	1,2,3,4,5,6,7
4 <b>Kompetenca për jetë, punë dhe mjedis - Kontribues produktiv</b>	1,2,3,4,5,6,7,8
5 <b>Kompetenca personale - Individ i shëndoshë</b>	1,2,3,4,5,6,7,8,9,10
6 <b>Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm</b>	1,2,3,4,5,6,7,8
<b>Fjalët kyçe:</b> : Dokument, formule, shkrim, dëshmi	
<b>Rezultatet e të nxënëtit.</b>	
<p><b>Njohuri gjuhësore:</b> Aftësi komunikuese            -Drejtohen dhe shprehen në mënyrë adekuate nëpërmjet gjuhës së folur dhe të shkruar.  <b>Shkathësi :</b> Të zgjidhurit e problemeve            -Gjykojnë në mënyrë kritike dhe janë kreativë</p>	
<p><b>Sjellje:</b>            Puna grupore,  <b>Qëndrime :</b>            Vetëvlerësimi</p>	
<p><b>Vlera:</b>            Puna grupore, Kreativiteti, Të menduarit kritik  <b>Shprehi :</b>            Të lexuarit, Të shkruarit</p>	
<p><b>Kriteret e suksesit-Rezultate</b></p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- analizon dokumentet e para të gjuhës së shkruar shqipe;</li> <li>- debaton rreth dokumenteve të para të shkrimit shqip dhe autorët e tyre;</li> <li>- analizon shkaqet e dokumentimit të vonshëm të gjuhës së shkruar shqipe;</li> </ul>	

## ZHVILLIMI I MËSIMIT

### **E □ Stuhi mendimi**

Rikujtohen njohuritë për historikun e zhvillimit të gjuhës shqipe

*Cila është origjina e gjuhës shqipe?*

*Në cilin grup të gjuhëve evropiane bën pjesë gjuha shqipe?*

Nga e ka prejardhjen gjuha shqipe?


*Cili gjuhëtar dëshmoi shkencërisht se shqipja është gjuhë indoeuropiane më vete?*

Dëgjohen me vëmendje përgjigjet e nxënësve. Nxënësit lejohen të shkëmbejnë mendime me njëri-tjetrin.

### **R □ Bashkëbisedim**

Mësuesi ja u kërkon nxënësve t'u përgjigjen pyetjeve :

- Cili është dokumenti i parë i shkruar në gjuhën shqipe ?
- Kur u botua "Meshari" dhe kush ishte autor i?
- Ç'përbante pasthënia e këtij libri?
- Kur dhe nga kush është shkruar Doktrina e krështerë?
- Pse ka rëndësi :Fjalori Latinisht-shqip" i F.Bardhit?
- Cilët janë autorët dhe veprat e shkrimit tarëve arbëreshë?



### **R□Punë e pavarur**

Ktheje në gjuhën e sotme një fragment nga "Meshari" i Buzukut

#### **LIDHJA ME FUSHAT E TJERA:**

Histori

#### **VLERËSIMI:**

Vlerësohen nxënësit për përfshirjen e tyre në diskutim dhe saktësinë e përgjigjeve të dhëna.

#### **DETYRË SHTËPIE :**

punë e diferençuar

Fusha e kurrikulës- Gjuhë dhe komunikim

Shkalla e Kurrikulës/3/Klasa : VII

Lënda : Gjuhë shqipe

Tema mësimore: **Dialektet e shqipes dhe gjuha standarde**

Njësia mësimore:Dialektet e shqipes

<b>Materiale dhe mjete mësimore</b> Teksti mësimor <i>Gjuha shqipe 7</i> , fletore, harta e trojeve shqiptare, njojuritë e nnxënësit	<b>Metoda dhe teknika mësimore.</b> stuhi mendimi, punë e drejtar, organizues grafik, punë e pavarur, diagrami i Venit
<b>Përdorimi i teknologjisë informative :</b>	
<b>Kontributi në kompetencat kryesore :</b>	
1 <b>Kompetenca në komunikim dhe të shprehur -- Komunikues efektiv</b>	1,2,3,4,5,6,7,8
2 <b>Kompetenca të të menduarit -- Mendimtar kreativ dhe kritik</b>	1,2,3,4,5,6,7,8
3 <b>Kompetenca të të mësuarit për të nxënë- Nxënës i suksesshëm</b>	1,2,3,4,5,6,7
4 <b>Kompetenca për jetë, punë dhe mjedis - Kontribues produktiv</b>	1,2,3,4,5,6,7,8
5 <b>Kompetenca personale - Individ i shëndoshë</b>	1,2,3,4,5,6,7,8,9,10
6 <b>Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm</b>	1,2,3,4,5,6,7,8
<b>Fjalët kyçë:</b> : Dialekt, variant, gjuhë standardw	
<b>Rezultatet e të nxënëtit.</b>	
<p><b>Njohuri gjuhësore:</b> Aftësi komunikuese            -Drejtohen dhe shprehen në mënyrë adekuate nëpërmjet gjuhës së folur dhe të shkruar.  <b>Shkathësi :</b>Të zgjidhurit e problemeve            - Gjykojnë në mënyrë kritike dhe janë kreativë            - Zhvillon personalitetin dhe humanitetin</p>	
<p><b>Sjellje:</b>            Dëshmojne vullnet dhe gatishmëri për punë individuale dhe në grupe  <b>Qëndrime:</b>            Vetëvlerësimi            Tregon vetëbesimin për punë të pavarur</p>	
<p><b>Vlera:</b>            Puna grupore, Kreativiteti, Të menduarit kritik  <b>Shprehi:</b>            Të lexuarit, Të shkruarit            Tregon kureshtje për hulumtimin</p>	
<p><b>Kriteret e suksesit-Rezultate</b>            Nxënësi/ja:            - dallon dialekten e shqipes dhe shtrirjen e tyre gjeografike;            - identifikon ndryshimet ndërmjet dialekteve të shqipes;            - zbaton rregullat gjuhësore për t'i shprehur mendimet;            - kthen në gjuhën standarde fjalë dialektore.</p>	
<b>ZHVILLIMI I MËSIMIT</b>	
<p><b>E <input type="checkbox"/> Stuhi mendimi.</b>            Mësuesi/ja vendos hartën e trojeve shqiptare në tabelë dhe u kërkon nxënësve t'u përgjigjen pyetjeve:  <i>Cilat janë dialekten e shqipes?</i>  <i>Ku shtrihen ato? Cili është kufiri natyror që ndan dy dialekten e shqipes?</i></p>	

*Në cilat fusha vihen re ndryshimet më të mëdha midis dialekteve?*

Dëgjohen me vëmendje përgjigjet e nxënësve. Nxënësit lejohen të shkëmbijnë mendime me njëri-tjetrin.

Nxiten të sjellin argumente për të mbrojtur idetë e tyre.

#### R □ *Punë e drejtuar, organizues grafik*

Nxënësve u kërkohet që të lexojnë dy tekstet e dhëna nga mesuesi/ja dhe të përcaktojnë se në cilin dialekt janë shkruar ato. Gjithashtu, ata japidan disa nga karakteristikat që i dallojnë në leksik dhe në fonetikë.

Nxënësit tregojnë se teksti i parë i përket dialektit verior ose gegërisht. Ata dallojnë:

- nga leksiku fjalët: *motit, kreni, lua, droja* etj.
- nga ana fonetike: *muer, bante, strofujt e vet* etj.

Ndërsa teksti i dytë i përket dialektit jugor ose toskërisht. Ata dallojnë:

- *nga leksiku*: fukarenj, pjekësh, gjysmët, aherë etj.
- *nga ana fonetike*: njëherë, do ta ndajë etj.

Mbështetur në përgjigjet e dhëna nga nxënësit mësuesi/ja plotëson në tabelë organizuesin grafik të ndryshimeve fonetike, morfolожike e leksikore të të dyja dialekteve

#### Organizuesi grafik: ndryshimet fonetike

Gegërisht	Toskërisht
Ue	Ua
A	Ë
N	I
Nuk ruan grupet e bashkëtingëlloreve <i>mb, nd, ng, ngj</i>	Ruan grupet e bashkëtingëlloreve mb, nd, ng, ngj
Vo	Va

#### Organizuesi grafik: ndryshimet në morfolologji

Gegërisht	Toskërisht
ka përemra pronorë vetvetorë	mungojnë
Ka mbiemra prejfoljorë me prapashtesën <i>-shëm</i>	nuk ka mbiemra prejfoljorë me prapashtesën <i>-shëm</i> .
Ka formën <i>me punue</i>	Ka formën <i>për të punuar</i>

#### Organizuesi grafik: ndryshimet në leksik

Gegërisht	Toskërisht
Dryn	Kyç
Mrij	Arrij
Shpin	kurriz
Katun	fshat

U kërkohet nxënësve që organizuesi grafik i ndryshimeve leksikore të plotësohet me

shembuj të tjerë duke kërkuar ndihmën e prindërve e të të afërmve.

**R□Punë e pavarur, diagrami i Venit**

Nxënësit nëpërmjet diagramit të Venit japid ndryshimet midis dy dialekteve të shqipes.

**LIDHJA ME FUSHAT E TJERA:**

Gjeografi

**VLERËSIMI:**

Vlerësohen nxënësit për përfshirjen e tyre në diskutim dhe saktësinë e përgjigjeve të dhëna.

**DETYRË SHTËPIE :**

**punë e diferencuar ushtrimi**

**Tema-Romani,novela,**

Fusha e kurrikulës- Gjuhë dhe komunikim

Shkalla e Kurrikulës/3/Klasa : VII

Lënda : Gjuhë shqipe

**Tema mësimore: Romani**

Njësia mësimore:Romani

**Materiale dhe mjete mësimore**

Tabela e zezë, shkumësa me ngjyra, gjuha shqipe

7

**Metoda dhe teknika mësimore.**

Organizues grafik

Diskutim

Ditari dypjesësh

**Përdorimi i teknologjisë informative :**

**Kontributi në kompetencat kryesore :**

1	<b>Kompetenca komunikim dhe të shprehur -- Komunikues efektiv</b>	1,2,3,4,5,6,7,8
2	<b>Kompetenca të të menduarit -- Mendimtar kreativ dhe kritik</b>	1,2,3,4,5,6,7,8
3	<b>Kompetenca të të mësuarit për të nxënë - Nxënës i suksesshëm</b>	1,2,3,4,5,6,7
4	<b>Kompetenca për jetë, punë dhe mijedis - Kontribues produktiv</b>	1,2,3,4,5,6,7,8
5	<b>Kompetenca personale - Individ i shëndoshë</b>	1,2,3,4,5,6,7,8,9,10
6	<b>Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm</b>	1,2,3,4,5,6,7,8

**Fjalët kyçë:** : shkrim letrar, personazhe, hapësirë dhe kohë, vend, kompozicion

**Rezultatet e të nxënëtit.**

**Njohuri gjuhësore:** Aftësi komunikuese

-Drejtohen dhe shprehen në mënyrë adekuate nëpërmjet gjuhës së folur dhe të shkruar.

**Shkathtesi :** Të zgjidhurit e problemeve

-Zhvillon imaginatën dhe kreativitetin

**Sjellje:**

Merr pjesë në diskutim

**Qëndrime :**

Vetëvlerësimi

**Vlera:**

Respekton mendimin e të tjërëve

**Shprehi :**

Të lexuarit, Të shkruarit

**Kriteret e suksesit-Resultate**

Nxënësi/ja:

- Identifikon veçoritë e romanit
- Lexon dhe identifikon karakteristikat strukturore të tekstit
- Ndërtzon organizuesin grafik të personazhit të mbështetur në tekstin e dhënë dhe në imagjinatën e tij.

•

**ZHVILLIMI I MËSIMIT**

**E □ Organizues grafik**

. Në këtë etapë mësuesi/ja i njeh nxënësit me romanin nga është shkëputur fragmenti me të njëjtin titull, llojin dhe veçorinë e tij dalluese në lidhje me romanin tradicional. Nxënësit plotësojnë skedën me veçorinë e romanit.

Skeda

Romani është vepër letrare që përmban mbi 50.000 fjalë ose mbi 120 faqe.

Romani është shumë i zhvilluar në letërsinë shqipe.

Romani është më kompleks sesa novela dhe ka më shumë se një komplot ose linjë rrëfimi.

Romani nuk ka kufij të jashtëm në kuptim të gjatësisë.

Ka shumë personazhe.

Lexohet fragmenti "Ruga e shtëpisë sime" Nazmi Rrahmani.

**R □ Diskutim**

Mësuesi/ja drejton pyetjet e mëposhtme:

- Kush është personazhi kryesor i fragmentit?
- A është i qartë për ju vendi se ku zhvillohet ngjarja? Po koha?
- Për cilën kohë flet ai?

**R □ Ditari dypjesësh**

Në mënyrë individuale nxënësit me anë të ditarit dypjesësh do të japid mendimet e tyre për pjesën që u ka lënë më shumë përshtypje nga ky fragment dhe arsyen?

Pjesë nga teksti	Koment
	Pse e zgjodhe pikërisht këtë pjesë? Ç'të veçantë kishte kjo pjesë? Si u ndjeve në ato momente? Etj.

LIDHJA ME FUSHAT E TJERA:	<b>VLERËSIMI:</b> Vlerëson nxënësit bazuar në plotësimin e tabelës së ditarit dypjesësh, aktivizimin dhe përqendrimin e tyre. Në dhënien e përgjigjeve.
---------------------------	--

**DETYRË SHTËPIE :**

Përshtypjet për fragmentin e lexuar.

**Fusha e kurrikulës- Gjuhë dhe komunikim****Shkalla e Kurrikulës/3/Klasa VII****Lënda : Gjuhë shqipe****Tema mësimore:Romani**

Njësia mësimore:"Rruga e shtëpisë sime"-fragment (tekst letrar ora I)

**Materiale dhe mjete mësimore**

Teksti Ana

**Metoda dhe teknika mësimore.**

Stuhi mendimesh, Tabela e parashikimeve, Shkrim i lirë

**Përdorimi i teknologjisë informative :****Kontributi në kompetencat kryesore :**

1	<b>Kompetenca komunikim dhe të shprehur -- Komunikues efektiv</b>	1,2,3,4,5, <b>6</b> ,7,8
2	<b>Kompetenca të të menduarit -- Mendimtar kreativ dhe kritik</b>	1,2,3, <b>4</b> ,5,6,7,8
3	<b>Kompetenca të të mësuarit për të nxënë- Nxënës i suksesshëm</b>	1,2,3,4,5,6,7
4	<b>Kompetenca për jetë, punë dhe mjedis - Kontribues produktiv</b>	1,2,3, <b>4</b> ,5,6,7,8
5	<b>Kompetenca personale - Individ i shëndoshë</b>	1,2,3,4,5,6,7, <b>8</b> ,9,10
6	<b>Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm</b>	1,2,3,4,5,6,7,8

Fjalët kyçe:roman, fragment, ngjarje, personazhe

**Rezultatet e të nxenit.****Njohuri gjuhësore:** Aftësi komunikuese

- Komunikon mirë

**Shkathtesi :** Të zgjidhurit e problemeve

-Gjykojnë në mënyrë kritike dhe janë kreativë

**Sjellje:**

Tregojne vetëbesimin për punë të pavarur

**Qëndrime :**

Vetëvlerësimi

**Vlera:**

Përdorin imagjinatën dhe kreativitetin

**Shprehi :**

Të lexuarit, Të shkruarit

**Kriteret e suksesit-Resultate**

- Lexon rrjedhshëm, me intonacion të duhur fragmentin "Rruga e shtëpisë sime";
- Veçon porosinë kryesore të fragmentit;
- Shpreh mendimin/gjykimin e vet të pavarur për personazhet e tregimit;
- Shpreh mendimin/gjykimin e vet duke bërë analogji dhe krahasime të ngjarjes në tekston, me ngjarjet e vitit 1999.

## **ZHVILLIMI I MËSIMIT**

### **E □ Stuhi mendimesh**

Së pari mësuesi/ja kërkon nga nxënësit që të kujtojnë ndonjë tregim nga prindërit dhe gjyshërit për vuajtjet e popullit tonë nën okupim.

### **R □ Tabela e parashikimeve**

Mësuesi/ja i njofton me temën dhe shkurtimisht i njofton se kjo pjesë është marrë nga romani për fëmijë “Ruga e shtëpisë sime”. Në këtë roman autori trajton çaste ngajeta e një familjeje shqiptar e cila detyrohet ta lëshojë shtëpinë dhe të largohet nga shkaku i dhunës së egër e barbare të armiqve të vendit tonë.

Teksti lexohet nga një nxënësit ose mësimdhënësi/ja.

Teksti ndahet në tri ndalesa. Pas secilës ndalesë nxënësit plotësojnë tabelën e parashikimeve:

Çfarë mendoni se do të              Çfarë provash keni?              Çfarë ndodhi?  
ndodhë?

I

II

III

### **R□Shkrim i lirë**

Përshtypjet e juaja për tekstin

#### **LIDHJA ME FUSHAT E TJERA:**

Edukatë qytetare

#### **VLERËSIMI:**

Sipas gjykimit të mësuesit,  
vetëvlerësim

#### **DETÝRË SHTËPIE :**

#### **Fusha e kurrikulës- Gjuhë dhe komunikim**

#### **Shkalla e Kurrikulës/3/Klasse VII**

Lënda : Gjuhë shqipe

#### **Tema mësimore:Romani**

Njësia mësimore;” Ruga e shtëpisë sime”-fragment ( ora II)

#### **Materiale dhe mjetë mësimore**

Teksti Gjuha shqipe 7, përvuja të nxënësve

#### **Metoda dhe teknika mësimore**

pyetje-përgjigje, diskutim, shkrim i lirë

#### **Përdorimi i teknologjisë informative :**

### Kontributi në kompetencat kryesore :

1	<b>Kompetenca komunikim dhe të shprehur -- Komunikues efektiv</b>	1,2,3,4,5,6,7,8
2	<b>Kompetenca të të menduarit -- Mendimtar kreativ dhe kritik</b>	1,2,3,4,5,6,7,8
3	<b>Kompetenca të të mësuarit për të nxënë- Nxënës i suksesshëm</b>	1,2,3,4,5,6,7
4	<b>Kompetenca për jetë, punë dhe mjedis - Kontribues produktiv</b>	1,2,3,4,5,6,7,8
5	<b>Kompetenca personale - Individ i shëndoshë</b>	1,2,3,4,5,6,7,8,9,10
6	<b>Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm</b>	1,2,3,4,5,6,7,8

Fjalët kyçe:refugiatë,shtëpi,largim,dhimbje,urrejtje

### Resultatet e të nxënëtit.

**Njohuri gjuhësore:** Aftësi komunikuese

- Komunikon mirë

**Shkathësi :**Të zgjidhurit e problemeve

-Gjykojnë në mënyrë kritike dhe janë kreativë

**Sjellje:**

Tregojne vetëbesimin për punë të pavarur

**Qëndrime :**

Vetëvlerësimi

**Vlera:**

Përdorin imagjinatën dhe kreativitetin

**Shprehi :**

Të lexuarit, Të shkruarit

### Kriteret e suksesit-Resultate

- Diskuton për përbajtjen e tekstit;
- komenton fragmente nga teksti me ditarët e të nxënëtit;
- analizon gjuhën dhe stilin e autorit në rrëfim;
- argumenton mendimin e tij në rrjetin e diskutimit;
- Ndërlidh ngjarjet e tregimit, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka.

### ZHVILLIMI I MËSIMIT

#### **E Stuhi mendimesh-Pyetje-përgjigje**

1. Cila ishte pamja e gruas nga teksti ? Pse mendoni se ishte e trishtuar?
2. Riprodhoni në mënyrë të përbledhur fjalët e personazhit (djalit) në tekst.
3. Çka ndodhi në fshatin Përroi i keq?
4. Nëna dhe gjyshja për çfarë flisnin?
5. Shënoni me + fjalinë e saktë dhe me - të gabuarën:
  - Nëna kishte jetuar që nga martesa e saj në atë shtëpi.
  - Vështrimi i saj në ato çaste ishte i humbur, ashtu si ishte edhe pamja e saj atë ditë.
  - Gjyshja ia lëshoi një shikim të rreptë e qortues.
  - Familja ishte e lumtur që po largohej.
  - Babai e shikoi nënën i habitur.

- Nëna filloj të shante me zë të lartë.
- Babai u pendua për veprimin që bëri (ikjen nga shtëpia).

**R □ Diskutim**

- Mësimdhënësi/ja u kërkon nxënësve që të shkruajnë me një fjali temën e tregimit. Gjejeni një titull tjetër për tregimin.
- Gjejini shkaqet e jetesës së vështirë në Përronin e keq:

Ilustrojeni këtë me shembuj nga teksti

- Ndaluni në mënyrën e komunikimit të nënës me babain. Është ky një komunikim: me sy, me gjeste, me veprime, me fjalë? Ilustrojeni mendimin tuaj me shembuj nga teksti
- Pavarësisht se si sillet, si mendoni ju: Çfarë urrente nëna? Ku duket kjo?

**R □ Shkrim i lirë**

Përshkruani në fletore personazhin e nënës, sipas kësaj skeme:

Të dhënat personale ( mosha)

Gjendja shoqërore (Nga është, ku banon)

Pamja (Cilësitet fizike: fytyra, flokët, sytë, sjellja etj.)

Veshja Rrobat që ka veshur në çastin e përshkrimit)

Karakteri (Cilësitet e karakterit)

**IDEJA (Mesazhi)** Nëse tema e një vepre është ajo për të cilën flitet, **ideja është mesazhi**, porosia që vepra (autori) i ofron lexuesit. Në tregimin “Ruga e shtëpisë sime” cili është mesazhi i autorit dhe çfarë synon të paraqesë?

**LIDHJA ME FUSHAT E TJERA:**

Ed.qytetare

**VLERËSIMI:**

Sipas gjykimit të mësuesit,  
vetëvlerësim

**DETÝRË SHTËPIE :** Shkruani nga një fjali ku të tregoni se si sillen me nënën: Babai, gjyshja dhe djali. Zgjidhni dhe përdorni këto fjalë kyçë që lidhen me secilin prej tyre!

Fusha e kurrikulës- Gjuhë dhe komunikim

Shkalla e Kurrikulës/3/Klasa : VII

Lënda : Gjuhë shqipe

**Tema mësimore: Novela**

Njësia mësimore:Novela

**Materiale dhe mjete mësimore**

Tabela e zezë, shkumësa me ngjyra, gjuha shqipe

7

**Metoda dhe teknika mësimore.**

Empatia

Lexim në heshtje

Diskutim

**Përdorimi i teknologjisë informative :**

**Kontributi në kompetencat kryesore :**

1	<b>Kompetencia komunikim dhe të shprehur -- Komunikues efektiv</b>	1,2,3,4,5,6,7,8
2	<b>Kompetencia të të menduarit -- Mendimtar kreativ dhe kritik</b>	1,2,3,4,5,6,7,8
3	<b>Kompetencia të të mësuarit për të nxënë- Nxënës i suksesshëm</b>	1,2,3,4,5,6,7
4	<b>Kompetencia për jetë, punë dhe mjedis - Kontribues produktiv</b>	1,2,3,4,5,6,7,8
5	<b>Kompetencia personale - Individ i</b>	1,2,3,4,5,6,7,8,9,10

	<b>shëndoshë</b>	
6	<b>Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm</b>	1,2,3,4,5,6,7,8
<b>Fjalët kyçë:</b> shkrim letrar, i shkurtër, pak personazhe, shtjellon problem		
<p><b>Rezultatet e të nxënëtit.</b></p> <p><b>Njohuri gjuhësore:</b> Aftësi komunikuese -Drejtohen dhe shprehen në mënyrë adekuate nëpërmjet gjuhës së folur dhe të shkruar.</p> <p><b>Shkathtësi :</b>Të zgjidhurit e problemeve -Zhvillon imaginatën dhe kreativitetin</p> <p><b>Sjellje:</b> Merr pjesë në diskutim</p> <p><b>Qëndrime :</b> Vetëvlerësimi</p> <p><b>Vlera:</b> Respekton mendimin e të tjera</p> <p><b>Shprehi :</b> Të lexuarit, Të shkruarit</p>		
<p><b>Kriteret e suksesit-Rezultate</b></p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Shkruan tekst deri në 500 fjalë, sipas detyrës së dhënë;</li> <li>- Krahason ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet novelës dhe romanit;</li> <li>- Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka.</li> </ul>		
<b>ZHVILLIMI I MËSIMIT</b>		
<p><b>E <input type="checkbox"/> Empatia</b></p> <p>Pasi nxënësit njihen me të gjithë informacionin e përgatitur për autorin e tekstit Ismail Kadare, nxënësit njihen me veçoritë e tregimit</p> <p>. Ata duhet t'u përgjigjen pyetjeve të mësuesit, përgjigjet e të cilave do t'i shkruajnë në një skedë.</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Ç'është tregimi?</li> <li>2. Cila është zanafilla e shkrimit të tij?</li> <li>3. Si paraqiten elementet e subjektit në tregim.</li> </ol> <p style="text-align: right;">Skeda</p> <p>Tregimi është lloji më i shkurtër i prozës.</p> <p><i>Zanafilla e tij janë legjendat, përrallat, gojëdhënat.</i></p> <p><i>Zakonisht tregimi ka një personazh qendror, ndërsa personazhet e tjera janë në funksion të tij. Subjekti është i thjeshtë, konflikti i ngjeshur.</i></p> <p>Më pas nxënësit dallojnë në informacionin e dhënë në tekst veçoritë e novelës, të cilat i nënvízojnë me laps dhe plotësojnë skedën.</p> <p style="text-align: right;">Skeda</p> <p>Novela është një lloj proze, më e shkurtër se romani por më e gjatë se tregimi. Ka një numër të kufizuar personazhesh. Ngjarjet zhvillohen rrotull një motivi qendror dhe arrihet në</p>		

përfundim të befasishëm. Ka ngashmëri me përrallën, kur gërshetohen elementet reale me ato fantastike. Rrëfimi i autorit mbizotëron në raport me dialogun.

**R □ Lexim në heshtje**

Kalohet në lexim në heshtje të pjesës 'Kush e solli Doruntinën". Udhëzohen nxënësit që gjatë leximit të nënvizojnë me laps:  
kohën, vendin ku zhvillohet ngjarja;  
personazhet kryesore të fragmentit;  
ngjarjet kryesore;  
mbylljen e ngjarjes.

Dëgjohen me vëmendje përgjigjet e nxënësve, të cilët çdo përgjigje e konkretizojnë me fjalët a grupet e fjalëve të nënizuara. Nxënësit zbulojnë mesazhin e fragmentit.

**R Teknika e pyetjeve**

-Rreth cilës çështje (problem) zhvillohet ngjarja?  
Sa është numri i personazheve - a është i madh apo i kufizuar?  
Kush janë personazhe?

<b>LIDHJA ME FUSHAT E TJERA:</b>	<b>VLERËSIMI:</b> vlerëson nxënësit bazuar në përgjigjet e tyre, aktivizimin dhe përqendrimin e tyre..
----------------------------------	---

**DETÝRË SHTËPIE :**

**Fusha e kurrikulës- Gjuhë dhe komunikim**

**Shkalla e Kurrikulës/3/Klasse VII**

**Lënda : Gjuhë shqipe**

**Tema mësimore:Novela**

Njësia mësimore:"Kush e solli Doruntinën"-Ismail.Kadare

**Materiale dhe mjete mësimore**

Leximi 7, tabela, shkumësa me ngjyra, fletore, lapsa,

**Metoda dhe teknika mësimore.**

Stuhi mendimi,Ditar dypjesësh, diskutim

**Përdorimi i teknologjisë informative :**

**Kontributi në kompetencat kryesore :**

1	<b>Kompetenca komunikim dhe të shprehur -- Komunikues efektiv</b>	1,2,3,4,5,6,7,8
2	<b>Kompetenca të të menduarit -- Mendimtar kreativ dhe kritik</b>	1,2,3,4,5,6,7,8
3	<b>Kompetenca të të mësuarit për të nxënë- Nxënës i suksesshëm</b>	1,2,3,4,5,6,7
4	<b>Kompetenca për jetë, punë dhe mjedis - Kontribues produktiv</b>	1,2,3,4,5,6,7,8
5	<b>Kompetenca personale - Individ i shëndoshë</b>	1,2,3,4,5,6,7,8,9,10
6	<b>Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm</b>	1,2,3,4,5,6,7,8

**Fjalët kyçë:** novelë, baladë, element fantastik

### **Rezultatet e të nxënitet.**

**Njohuri gjuhësore:** Aftësi komunikuese

- Komunikon mirë

**Shkathësi :** Të zgjidhurit e problemeve

-Gjykojnë në mënyrë kritike dhe janë kreativë

**Sjellje:**

Tregojne vetëbesimin për punë të pavarur

**Qëndrime :**

Vetëvlerësimi

**Vlera:**

Përdorin imagjinatën dhe kreativitetin

**Shprehi :**

Të lexuarit, Të shkruarit

### **Kriteret e suksesit-Resultate**

- Lexon rrjedhshëm, me intonacion të duhur
- Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën
- Shpreh mendimin/gjykimin për gjendjen psikologjike të dy personazheve të novelës: nënës, Doruntinës;
- dallon gërshtetimin e elementeve fantastike të baladës me elementet e prozës moderne;
- pasuron fjalorin me fjalë dhe shprehje të reja

## **ZHVILLIMI I MËSIMIT**

### **E □ Brainstorming**

Mësuesi/ja rikujton njohuritë për veçoritë e tregimit, novelës. Këtë mësuesi/ja e realizon përmes pyetjeve.

### **R □ Ditari dypjesësh**

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit për leximin e tekstit në heshtje duke mbajtur shënimë në formën e ditarit dypjesësh, ku do t'i klasifikojnë informacionet

Elementi fantastik

*Element i prozës moderne*

- |  |  |
|--|--|
| <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Ringjallja e Konstantinit</i></li> <li>- Udhëtimi i Doruntinës me vëllanë e vdekur</li> <li>- Biseda e zogjeve</li> <li>- Shndërrimi i objekteve Rrasa në kalë</li> <li>Balta në shalë etj.</li> </ul> | <ul style="list-style-type: none"> <li>- Ligjërimi është bashkëkohës në gjuhë.</li> <li>- Rrëfyesi është ndërlidhës i mesazheve nga e shkuara në të tashmen e të ardhmen</li> <li>- Modernizohen karakteret letrare të përshkruara në mënyrën e të menduarit e të ndjerit, dijet, synimet, madje dhe mjediset</li> </ul> |
|--|--|

Diskutohet mënyra e gërshtetimit të këtyre elementeve në tekst

**LIDHJA ME FUSHAT E TJERA:**

**VLERËSIMI:**

Nxënësit vlerësohen për përgjigjet e dhëna dhe shkrimit të lirë

**DETÝRË SHTËPIE :** Nxënësit japin argumentet e tyre nëse novela e Kadaresë është përshtatje apo krijim original.

**Fusha e kurrikulës- Gjuhë dhe komunikim****Shkalla e Kurrikulës/3/Klasa VII****Lënda : Gjuhë shqipe****Tema mësimore:Novela**

Njësia mësimore:”Kush e solli Doruntinën”-Ismail.Kadare(Ora e dytë)

**Materiale dhe mjete mësimore**

teksti mesimor, novela “Kush e solli Doruntinën”, informacione për I. Kadarenë

**Metoda dhe teknika mësimore.**

Diskutim; Kllaster; Lexim zinxhir;

**Përdorimi i teknologjisë informative :****Kontributi në kompetencat kryesore :**

1	<b>Kompetenca komunikim dhe të shprehur -- Komunikues efektiv</b>	1,2,3,4,5, <b>6,7,8</b>
2	<b>Kompetenca të të menduarit -- Mendimtar kreativ dhe kritik</b>	1,2,3,4,5,6,7,8
3	<b>Kompetenca të të mësuarit për të nxënë- Nxënës i suksesshëm</b>	<b>1,2,3,4,5,6,7</b>
4	<b>Kompetenca për jetë, punë dhe mijedis - Kontribues produktiv</b>	1,2,3,4,5,6,7,8
5	<b>Kompetenca personale - Individ i shëndoshë</b>	1,2,3,4,5,6,7,8,9,10
6	<b>Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm</b>	1,2,3,4,5,6,7,8

Fjalët kyçë: përbajtje, Zonja Mëmë, Doruntina, vajtojcat, ligjërimi

**Resultatet e të nxënëtit.****Njohuri gjuhësore:** Aftësi komunikuese

- Komunikon mirë

**Shkathtësi :**Të zgjidhurit e problemeve

-Gjykojnë në mënyrë kritike dhe janë kreativë

**Sjellje:**

Tregojne vetëbesimin për punë të pavarur

**Qëndrime :**

Vetëvlerësimi

**Vlera:**

Përdorin imagjinatën dhe kreativitetin

**Shprehi :**

Të lexuarit, Të shkruarit

**Kriteret e suksesit-Resultate**

- Lexon rrjedhshëm, me intonacion të duhur;
- Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën;
- Shpreh mendimin/gjykimin për gjendjen psikologjike të dy personazheve të novelës: nënës, Doruntinës;
- dallon gërshtimin e elementeve fantastike të baladës me elementet e prozës moderne;
- pasuron fjalorin me fjalë dhe shprehje të reja.


## ZHVILLIMI I MËSIMIT

### **E □ Brainstorming**

Njihen nxënësit me temën e re të mësimit dhe diskutojnë rreth baladës “Kostandini dhe Doruntina”

Si jepet ngjarja në baladë? C’ndodh me Doruntinën? Po me vëllezërit e saj? Cili është motivi qendror i baladës?

Nxënësve u është kërkuar paraprakisht të gjejnë informacione për jetën dhe veprën letrare të shkrimtarit Ismail Kadare.



### **R □ Ditari dypjesësh**

Lexohet fragmenti i shkëputur nga novela me të njëtin titull e shkrimtarit Ismail Kadare.

Duke njojur baladën themi se Kadareja e ka nisur ngjarjen në novelë pikërisht aty ku përfundon ngjarja në baladë:

“....Një në prag e një në derë

Plasën si qelqe me verë.”

Fillon atë natë kur Doruntina kthehet në shtëpi. Personazhi kryesor, kapiten Stresi përpinqet të zbulojë kush e ka sjellë në të vërtetë Doruntinën në shtëpi, sepse nuk i besohet që Konstandini është ngritur prej varri për ta mbajtur besën.

Pasi lexojnë fragmentin, nxënësit rrëfejnë me fjalët e tyre përbajtjen e tij.

### **R□**

Kalohet në rubrikën “Kuptimi”

Punohet ushtrimi 2: Nëse e quajmë këtë spektakël dramë rrëqethëse, cilët janë aktorët e saj? Të gjallët, të vdekurit apo njëkohësisht të dyja palët? Nxënësit ilustrojnë mendimin e tyre me fjalët e librit.

Punë në dyshe: Ushtrimi 3. Komentoni këto dy fjali: “Herë – herë, sipas zakonit, vajtojcat i prinin vajit me fjalë në formë vargjesh. Herë njëra, herë tjetra e herë të katërtë së bashku, ato krijonin ppjesë të ngjarjes së jashtëzakonshme.

<b>LIDHJA ME FUSHAT E TJERA:</b> <b>Muzika</b>	<b>VLERËSIMI:</b> Bëhet vlerësimi i nxënësve për aktivizimin gjatë orës së mësimit, për saktësinë dhe argumentimin e përgjigjeve
---	---

**DETÝRË SHTËPIE :** Komentoni fjalët e fundit të Stresit.

**Fusha e kurrikulës- Gjuhë dhe komunikim****Shkalla e Kurrikulës/3/Klasa VII****Lënda : Gjuhë shqipe****Tema mësimore: Tekstet letrare dhe joletrare**

Njësia mësimore: Bisedë letrare mbi veprën

**Materiale dhe mjete mësimore**

Libri i përcaktuar për bisedë, fisha me të dhëna për autorin

**Metoda dhe teknika mësimore.**

diskutim, diagram Venit ose tabela e krahasimit të , tabela e koncepteve të personazhit, kllaster, ditarët e të nxënësit, analiza të ndryshme gjuhësore, shkrimi i një letre, shkrime të lira, shkrime esesh, karrige e nxehtë, empatia, punë në grupe etj

**Përdorimi i teknologjisë informative :****Kontributi në kompetencat kryesore :**

1	<b>Kompetenca komunikim dhe të shprehur - - Komunikues efektiv</b>	1,2,3,4,5, <b>6,7,8</b>
2	<b>Kompetenca të të menduarit -- Mendimtar kreativ dhe kritik</b>	1,2,3,4,5,6,7,8
3	<b>Kompetenca të të mësuarit për të nxënë- Nxënës i suksesshëm</b>	1,2,3,4,5,6,7
4	<b>Kompetenca për jetë, punë dhe mjedis - Kontribubes produktiv</b>	1,2,3,4,5,6,7,8
5	<b>Kompetenca personale - Individ i shëndoshë</b>	1,2,3,4,5,6,7,8,9,10
6	<b>Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm</b>	1,2,3,4,5,6,7,8

Fjalët kyçë:libër, personazh,vend, kohë, pjesa më e bukur, figura stilistike

**Rezultatet e të nxënëtit.****Njohuri gjuhësore:** Aftësi komunikuese

- Komunikon mirë

**Shkathësi :**Të zgjidhurat e problemeve

-Gjykojnë në mënyrë kritike dhe janë kreativë

**Sjellje:**

Tregojne vetëbesimin për punë të pavarur

**Qëndrime :**

Vetëvlerësimi

**Vlera:**

Përdorin imagjinatën dhe kreativitetin

**Shprehi :**

Të lexuarit, Të shkruarit

**Kriteret e suksesit-Resultate**

### Ora I

- jep informacion shkurtimisht për librin dhe autorin e tij;
- përbledh shkurt ngjarjet e librit, duke u bazuar në elementet e strukturës dhe të subjektit;
- ndërton pyetje, gjëza dhe enigma rreth librit për shokët;
- u përgjigjet pyetjeve që lidhen me të kuptuarit dhe interpretimin e librit;
- i përshkruan personazhet, duke përdorur teknika të ndryshme.

### Ora II

- bën analizën gjuhësore e stilistikore të librit;
- evidenton pjesët më të bukura nga libri duke argumentuar pse
- komenton me ditarët e të nxënët pjesë e shprehje të spikatura nga libri, fragmente, personazhe etj.;
- shkruan ese (tekste vlerësuese) rreth vlerave të librit;
- ilustron me vizatime ngjarje e personazhe nga libri;
- lidh jetën, ngjarjet e personazheve me jetën e tij etj.

### Ora III

- bën reklamën e librit për një gazetë, revistë
- dramatizon pjesënga libri;
- Pasuron dhe krijon një fjalor me fjalë kyç nga libri;
- i shkruan një letër shkrimitarit për librin;
- krijon një korrespondecë imaginare mes personazheve;
- krahason librin e autorit me një tjetër të tij, ose me një libër tjeter me të njëjtën tematikë

**Orientim:** Për bisedën letrare mund të punohen libra që shihen të arsyeshëm nga mësuesi/ja, sipas skemës që kemi dhënë më parë.

Nëse libri i përzgjedhur mund të jetë parashikuar në plan te të lexuarit në një fragment, mund të merren orët dhe biseda të zhvillohet për tri ose edhe katër orë

## Organizimi i orës së mësimit

Librat e bisedave letrare mund të përzgjidhen nga diskutimet, duke pasur parasysh gjendjen në bibliotekën e shkollës ose bibliotekën personale të nxënësve. Kjo përzgjedhje mund të bëhet në fillim

të çdo tremujori kur mund të përzgjidhen edhe libra që kanë fragmente në tekst.

## Ora I

### Nxënësi/ja:

- Jep informacion shkurtimisht për librin dhe autorin e tij.
- Përbledh shkurt ngjarjet e librit duke u bazuar në elementet e strukturës dhe të subjektit si: parashtrimi, pika e lidhjes, konflikti, pika kulmore, zgjidhja e konfliktit.
- Ndërton pyetje rreth librit për shokët.
- Diskuton dhe zhvillon të menduarit kritik nëpërmjet pyetjeve rreth të kuptuarit dhe interpretimit.
  - Shkruan ese analitike
  - Përshkruan personazhet duke përdorur teknika të ndryshme.
  - Analizon personazhet-dukja,sjellja,cilësitë,etj

Personazhet	Cilësi morale	Cilësi fizike	Ku duken	Mendime	veprime	Gjykimi yt për temën
-------------	------------------	------------------	----------	---------	---------	----------------------------

## Ora II

### Nxënësi/ja:

- Bën analizën gjuhësore e stilistikore të librit.
- Analizon fjalët e figurshme, leksikun.
- Pasuron fjalorin me fjalë të reja.
- Analizon raportet e përshkrimeve me dialogët.
- Përzgjedh pjesën më të bukur nga libri duke argumentuar pse.
- Lexon dhe komenton me ditarët e të nxënët pjesë dhe shprehje të spikatura nga libri
- Shkruan ese (tekste vlerësuese, krahasuese ) rreth vlerave të librit.
- Përdor ilustrime me vizatime për ngjarjet dhe personazhet nga libri.
- Shkruan dhe lidh jetën dhe ngjarjet e personazheve me jetën e tij.
- Analizon rolin e personazhit dhe gjykon se si do të sillej ai në të njëjtat situata.

**Nxënësi/ja:**

- Bën reklamën e librit për një gazetë
- Përdor teknologjinë digitale dhe realizon me softuere të ndryshme reklama për gazeta, revista.
- Përdor njohuritë për të dramatizuar pjesë nga libri.
- Lexon dhe identifikon karakteristikat strukturore të tekstit, si: heroin, subjektin, idenë, detajin, figurën, rrëfimin, përshkrimin.
- Pasuron fjalorin dhe krijon një fjalor me fjalë kyçë nga libri.
- I shkruan një letër shkrimtarit për librin.
- Krijon një korrespondecë imagjinare mes personazheve.
- Interpreton subjektin, idenë, rrëfimin, gjuhën e figurshme, vendin e hapësirën
- Shkruan ese krahasuese dhe krahason librin e autorit me një tjetër të tij ose me një libër me të njëjtën tematikë.
- Sjell ngjarjen e kohëve të vjetra në kohën moderne.
- Sipas fantazisë dhe në varësi të ngjarjeve të librit, nxënësit rikrijojnë pjesë nga teksti në kohë të ndryshme.
- Shkruan një mbyllje tjetër për librin.
- Klasa ndahet në grupe për t'u realizuar plotësisht të gjitha rezultatet

**LIDHJA ME FUSHAT E TJERA (varësisht nga libri)**

Shoqëria dhe mjedisi, Shkencat e natyrës, Arte, Tik,etj

**VLERËSIMI:**

Sipas gjykimit të mësuesit me notë dhe vetëvlerësim. Pjesë e vlerësimit të vazhdueshëm dhe domosdoshmërisht pjesë e vlerësimit në dosje.

**DETÝRË SHTËPIE :** Sipas gjykimit dhe rezultateve të të nxënëtit, që do të përcaktojmë për secilën orë.

**Tema, subjekti (fabula), personazhi /heroi, kompozicioni, gjuha****Teksti joletrar: teksti gazetaresk, informata, teksti edukativ, shëndetësor, reportazhi, intervista.****Elementet e prozës letrare**

Fusha e kurrikulës- Gjuhë dhe komunikim Shkalla e Kurrikulës/3/Klasa : VII Lënda : Gjuhë shqipe	
<b>Tema mësimore:Proza letrare</b> Njësia mësimore:Elementet e prozës letrare	
<b>Materiale dhe mjete mësimore</b> Teksti mësimor <i>Gjuha shqipe 7</i> , njojuritë e nnxënësit, interneti,etj	<b>Metoda dhe teknika mësimore.</b> stuhi mendimi, leksion i përparuar, bashkëbisëdim punë e pavarur,
<b>Përdorimi i teknologjisë informative :</b>	
<b>Kontributi në kompetencat kryesore :</b>	
1 <b>Kompetenca komunikim dhe të shprehur -- Komunikues efektiv</b>	1,2,3,4,5,6,7,8
2 <b>Kompetenca të të menduarit -- Mendimtar kreativ dhe kritik</b>	1,2,3,4,5,6,7,8
3 <b>Kompetenca të të mësuarit për të nxënë- Nxënës i suksesshëm</b>	1,2,3,4,5,6,7
4 <b>Kompetenca për jetë, punë dhe mjesid - Kontribues produktiv</b>	1,2,3,4,5,6,7,8
5 <b>Kompetenca personale - Individ i shëndoshë</b>	1,2,3,4,5,6,7,8,9,10
6 <b>Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm</b>	1,2,3,4,5,6,7,8
<b>Fjalët kyçe:</b> : tema(subjekti), ngjarja, koha, motive, stili,kompozicioni, narratori, këndvështrimi, personazhet	
<b>Rezultatet e të nxënëtit.</b>	
<b>Njohuri gjuhësore:</b> Aftësi komunikuese -Drejtohen dhe shprehen në mënyrë adekuate nëpërmjet gjuhës së folur dhe të shkruar. <b>Shkathësi :</b> Të zgjidhurit e problemeve -Gjykojnë në mënyrë kritike dhe janë kreativë	
<b>Sjellje:</b> Puna grupore, <b>Qëndrime :</b> Vetëvlerësimi <b>Vlera:</b> Puna grupore, Kreativiteti, Të menduarit kritik	
<b>Shprehi :</b> Të lexuarit, Të shkruarit <b>Kriteret e suksesit-Rezultate</b> Nxënësi/ja: - njeh elementet e prozës letrare -dallon temën e një proze letrare -analizon personazhet në një proze letrare -diskuton rrith këndvështrimit të një proze letrare	

**E □ Stuhi mendimi**

Rikujtohen njohuritë e nxënësve për prozën letrare :

- Çfarë përmban një prozë letrare?
- A ka subjekt(temë)?
- A ka personazhe?
- Si bëhet përshkrimi i ngjarjeve?
- Autori a e tregon ngjarjen sikur është vetë pjesmarrës apo tregon ngjarjen e të tjera,etj.

Nxënësit argumentojnë përgjigjet e tyre

**R □ Lekson i avancuar-Bashkëbisedim**

Elementet e prozës letrare janë të shumta dhe të komplikuara, por janë të domosdoshme për realizimin e një vepre letrare. Elementet kryesore janë tema apo subjekti i veprës, ngjarja, storia apo fabula që rrëfeshet, vendosja në kohë e hapësirë, personazhet, narratori, këndvështrimi, motivi, kompozicioni dhe/ose stil.

Pyetje:

Cilat janë elementet kryesore të një vepre letrare?

**Tema** është çështja që trajtohet, është subjekti themelor i ngjarjes, mbi të cilën ndërtohet fabula.

Tema e njëjtë mund të trajtohet edhe në vepër joletrete, për shembull në punim shkencor a në artikull gazete. Në secilin lloj të shkrimit përdoren teknika të ndryshme. Punimi shkencor, për shembull, nuk ka personazhe, ndërkund artikulli gazetaresk mund ta ketë një personazh, por ngjarjet duhet të janë të vërteta dhe të mbështetura në fakte, ndërsa koha dhe hapësira duhet të janë reale, siç nuk ndodh në një vepër letrare. Pyetje:

- C'është tema e një vepre letrare?
- A mund të kenë temë edhe veprat joletrete siç mund të janë punimet shkencore,gazetat,etj
- Cili shkrim mund të mos ketë personazhe?
- Ku dallojnë koha dhe hapësira në veprën letrare dhe joletrete?

**Ngjarja** apo linja e rrëfimit, është rendi apo renditja e ngjarjeve dhe veprimeve të një storieje. Nis me ngjarjen fillestare pastaj veprimi shkon duke u rritur. Më pas zhvillohet konflikti, për të arritur kulminacionin. Pasi të arrihet kulminacioni, nis të bjerë intensiteti i rrëfimit dhe ngjarja përfundon duke u rrumbullakësuar e ndonjëherë edhe duke u zgjidhur.

Kulminaconi i romanit përbëhet nga një fjali e vetme e paketuar brenda një veprimi përmes të cilit zgjidhet konflikti i romanit. Kjo fjali vjen kah fundi i romanit. Pjesa kryesore e veprimit ndodh para kulminaconit. Konflikti apo intriga ka edhe një strukturë të ndërmjetme: skenë dhe pasojë. Skena është një njësi e dramës, ku ndodh veprimi. Pastaj, pas njëfarë tranzicioni, vjen pasoja - një reagim emocional dhe rigrupim, si pasojë e tyre veprimit dhe zhvillimeve paraprake që kanë çuar deri aty. Pyetje

- C'do të thotë ngjarja e tregimit?
- Si fillon ajo dhe si zhvillohet?
- Kur e arrinë kulminacionin një rrëfim?
- C'janë skena dhe pasoja?

**Hapësira dhe koha** ka të bëjë me vendin dhe kohën në të cilën vendoset ngjarja. Vendosja shpesh bëhet në një vend të vërtetë, por mund të jetë edhe një qytet ose vend imagjinari brenda botës sonë.

Vendosja, në thelb, ka të bëjë me atë se ku dhe kur zhvillohet ngjarja e rrëfyer.

**Motivi**-Tema është ajo që autor i përpinqet t'ia rrëfejë lexuesit. Për shembull, besimi në të mirën, apo që gjërat nuk janë gjithmonë ashtu siç duken. Ky shpesh quhet "moral i rrëfimit". Disa vepra letrare përbajnjë tema të avancuara si morali, ose vlera e jetës, ndërsa

tregimet e tjera nuk kanë temë, ose kanë temë shumë të cekët.

**Stili dhe kompozicioni** përfshin shumëllojshmérinë e zgjedhjeve që bëjnë shkrimtarët Për çdo pjesë të veprës, autori bën shumë zgjedhje të vetëdijshme apo të nënvetëdijshme, të cilat kombinohen për të formuar stilin unik të shkrimtarit. Komponentët e stilit janë të shumtë, por përfshijnë këndvështrimin, përzgjedhjen e narratorit, modelin e shkrimtit letrar, vetën dhe kohën, gramatikën, pikësimin, përdorimin e fjalëve, gjatësinë dhe strukturën e fjalive, gjatësinë dhe strukturën e paragrafit, dhe përzgjedhjen e titullit.

**Narratori (rrëfimtari)** është rrëfyesi i ngjarjes. Në letërsi njihen disa lloje narratorësh, por më të zakonshmit janë narratorët e vetës së parë dhe të vetës së tretë.

Narratori i vetës së pare flet nga këndvështrimi i vetës së parë. Ai përdor përemra si unë/ne, mua/neve, im/ynë/jonë etj. Narratori i vetës së parë zakonisht është personazh i veprës, pasi e rrëfen ngjarjen nga këndvështrimi i tij, që i bie se ai është i përfshirë në ngjarje dhe në njëfarë mënyre është pjesë e saj. Ky lloj i narratorit mund të tregojë se çka sheh e dëgjon, por nuk komenton veprimet në të cilat nuk merr pjesë drejtpërdrejt.

Narratori i vetës së dytë përmendet në disa teori të letërsisë, mirëpo raporti i tij me rrëfimin është i paqartë, pasi gjuhësish veta e dytë nuk rrëfen.

Narratori i vetës së tretë flet apo rrëfen nga këndvështrimi i vetës së tretë. Zakonisht përdor përemra ai/ajo/ata/ato, i, e tij/saj/i,e tyre etj. Narratorët e vetës së tretë ndahen në narratorë të kufizuar dhe narratorë omnishentë apo që dinë gjithçka. Narratori i kufizuar rrëfen sikurse narratori i vetës së parë, do me thënë për ato që sheh, por për dallim nuk është personazh, pra nuk merr pjesë drejtpërdrejt në ngjarje. Ky lloj i narratorit nuk është i zakonshëm në letërsi. Narratori omnishent është narrator i gjithëdijshëm, i cili nuk është personazh i ngjarjes, por e rrëfen atë nga një perspektivë e sipërme dhe rrëfen, komenton e shpjegon gjithçka. Ky narrator nuk është pjesë e rrëfimit, por rrëfen gjithçka dhe së këndejmi është lloji më i shpeshtë i narratorit në letërsi.

**Këndvështrimi apo pozita e narratorit apo perspektiva** narrative pëershkruan pozicionin e tregimtarit në lidhje me ngjarjen që rrëfehet. Për shembull, narratori i vetës së parë ka këndvështrim tjetër nga ai i vetës së tretë, pasi pozicionimi i tij në raport me ngjarjen është i ndryshëm - përderisa narratori i vetës së parë është personazh i ngjarjes, edhe pikëpamja apo këndvështrimi i tij për ngjarjen është i ndryshëm nga këndvështrimi i narratorit të vetë së tretë që nuk është fare personazh, por e shikon dhe e rrëfen ngjarjen nga një perspektivë tjetër.

**Personazhi** është pjesëmarrës në ngjarje dhe zakonisht është një person, por mund të jetë çdo person, identitet ose entitet, ekzistenza e të cilit rrjedh nga një vepër apo veprim imagjinar. Personazhet mund të jenë disa llojesh: • Personazh i këndvështrimit është personazhi përmes të cilit shihet ngjarja. Ai mund të jetë apo të mos jetë personazhi kryesor i ngjarjes; • Protagonist: personazhi kryesor i ngjarjes; • Antagonist: karakteri i cili qëndron në pozita të kundërtë me protagonistin; • Personazh i vogël: një personazh që ndërvepron me protagonistin. Personazhet e vogla ndihmojnë që të zhvillohet ngjarja. • Personazh kontrastiv: një personazh (zakonisht i vogël) i cili ka tipare të kundërtë me ato të personazhit kryesor.

#### R $\square$ Punë e pavavar

Në çifte, nxënësit analizojnë elementet e prozës letrare në tekstin "Kush e solli Doruntinën"- Kadare

<b>LIDHJA ME FUSHAT E TJERA:</b> Histori	<b>VLERËSIMI:</b> Vlerësim i vazhdueshëm
---	---

#### DETYRË SHTËPIE :

**punë e diferencuar**

<p>Fusha e kurrikulës- Gjuhë dhe komunikim        Shkalla e Kurrikulës/3/Klasa : VII        Lënda : Gjuhë shqipe</p>		
<p><b>Tema mësimore:</b> Teksti letrar dhe joletrar        Njësia mësimore: Teksti letrar dhe joletrar</p>		
<p><b>Materiale dhe mjetë mësimore:</b> teksti mësimor “Gjuhë shqipe 7”, tabela, shkumësa me ngjyra, fjalori i Gjuhës së Sotme Shqipe, tekste letrare e joletrare, modele</p>		<p><b>Metoda dhe teknika mësimore.</b>        Diagrami i Venit; Organizues grafik; Punë në grupe; Tryeza e rrumbullakët.</p>
<p><b>Përdorimi i teknologjisë informative :</b></p>		
<p><b>Kontributi në kompetencat kryesore :</b></p>		
1	<b>Kompetenca komunikim dhe të shprehur -- Komunikues efektiv</b>	1,2,3,4,5,6,7,8
2	<b>Kompetenca të të menduarit -- Mendimtar kreativ dhe kritik</b>	1,2,3,4,5,6,7,8
3	<b>Kompetenca të të mësuarit për të nxënë- Nxënës i suksesshëm</b>	1,2,3,4,5,6,7
4	<b>Kompetenca për jetë, punë dhe mijedis - Kontribues produktiv</b>	1,2,3,4,5,6,7,8
5	<b>Kompetenca personale - Individ i shëndoshë</b>	1,2,3,4,5,6,7,8,9,10
6	<b>Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm</b>	1,2,3,4,5,6,7,8
<p><b>Fjalët kyçë:</b> teksti letrar, teksti joletrar, përbajtje, strukturë, analizë, veçori gjuhësore, elemente komunikimi.</p>		
<p><b>Rezultatet e të nxënëtit.</b></p> <p><b>Njohuri gjuhësore:</b> Aftësi komunikuese        -Drejtohen dhe shprehen në mënyrë adekuate nëpërmjet gjuhës së folur dhe të shkruar.  <b>Shkathësi :</b> Të zgjidhurit e problemeve        -Gjykojnë në mënyrë kritike dhe janë kreativë</p> <p><b>Sjellje:</b>        Puna grupore,  <b>Qëndrime :</b>        Vetëvlerësimi</p> <p><b>Vlera:</b>        Puna grupore, Kreativiteti, Të menduarit kritik</p> <p><b>Shprehi :</b>        Të lexuarit, Të shkruarit</p>		
<p><b>Kriteret e suksesit-Resultate</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- liston karakteristikat e tekstit letrar dhe joletrar;</li> <li>- zërithen strukturën e teksteve;</li> <li>- krahason tekstet letrare dhe joletrare;</li> <li>-analizon këto tekste në formë dhe përbajtje.</li> </ul>		
<p><b>ZHVILLIMI I MËSIMIT</b></p> <p><b>E-Diagrami Venit</b>        Mësimi nis me informacione të dhëna nga mësuesi/ja (mbi tekstin letrar e joletrar, mbi</p>		

funksionin dhe qëllimet e tyre). Në tabelë, mësuesi/ja shkruan karakteristikat e tekstit joletar dhe letrar. Të gjitha karakteristikat, mësuesi/ja i liston në tabelë dhe i fton nxënësit të plotësojnë Diagramin e Venit, të flasin mbi të përbashkët, të vecantat e tekstit letrar e joletar. Nxënësit diskutojnë rrith teksteve, duke ilustruar diskutimet e tyre me fragmente nga tekstet.

### R-puna në grupe, organizues grafik

Mësuesi/ja ndan klasën në grupe. Secili grup ka një tekst joletar dhe një tekst letrar, me të cilët ndërton pyetje dhe jep përgjigje rrith tyre. Pyetjet janë specifike, si: "cila është tema?", "cila është ideja", mesazhi, referenti dhe gjuha e përdorur në këto tekste. Përfaqësuesi i grupit lexon përgjigjet.

Mësuesi/ja plotëson organizuesin grafik dhe bën pjesë në punës edhe nxënësit

### R-Tryeza e rrumbullakët

Tryezë e Rrumbullakët, ku vetë nxënësit do të zgjedhin shokët që plotësojnë karakteristikat, duke i shoqëruar me ilustrime nga tekstet (të përzgjedhura më përpara). Nxënësit e zgjedhur falënderojnë shokët për vlerësimin

Tekstet me funksion praktik – tesktet joletrare

Teksti	Ç'bën	Synimi	Lloji i tekstit
Rrëfyes	Tregon ngjarje reale me personazhe dhe vende reale	Të nxitë fantazinë e lexuesit.	Kronika, shënimë udhëtimi, biografi, intervista etj
Përshkrues	Përshkruan karakteristikat e njerëzve, kafshëve, sendeve, vendeve, objekteve.	Të përshkruajë cilësi fi zike e psikologjike, që lexuesi i percepton mendërisht.	Guida, traktate teknike, tekste shkencore etj.
Paraqitës	Paraqet të dhëna, informacione, shpjegon koncepte, teori mbi një argument të caktuar.	Të shpjegojë, të sqarojë, të ilustrojë një teori.	Njoftime, zërat e enciklopedive, përbledhje etj.
Argumentues	Mbështetin opinione, teza, vlerësohen fakte, gjëra, persona	Të bindë lexuesin për vlefshmërinë e tezës dhe të gjykimit të vet	Ese, artikuj politikë dhe propagandistikë etj.
Udhëzues	Jep udhëzime, këshilla, urdhra	Të udhëzojë, këshillojë, detyrojë, urdhërojë lexuesin që të ndjekë një qëndrim ose të kryejë veprime sipas një radhe të caktuar	Ligje, vendime, udhëzime, urdhra, receta, udhëzues përdorimi etj.

Tekstet me funksion estetik – tekstet letrare

Teksti	Ç'bën	Synimi	Lloji i tekstit
Tregimtar Rrëfyes ose narativ	Rrëfen për ngjarje ose personazhe reale ose të trilluara, ndërtohet sipas një strukture artistike.	Të pasqyrojë jetën nëpërmjet fi gurave artistike dhe të shkaktojë përjetime dhe emocione të caktuara te lexuesi.	Miti, legjenda, romani, novela, tregimi etj.

Poetik	Rrëfen për ngjarje ose personazhe nëpërmjet vargjeve dhe organizimeve të ndryshme tingullore, shpreh ndjenja e emocione nëpërmjet gjuhës së fi gurshme.	Të ndikojë thellë në mendjen, në zemrën e në ndjenjat e lexuesit, duke shfrytëzuar mjetet shprehëse të gjuhës.	Poema epike, eposi, ciklet e këngëve, poezia etj.
Dramatik	Rrëfen nëpërmjet personazheve veprues dhe lojës së aktorëve në skenë,	Të pasqyrojë jetën nëpërmjet gjuhës skenike (dialogëve dhe monologëve) dhe të shkaktojë përfjetime dhe emocione të caktuara te shikuesi.	Tragjedia, komedia, drama etj.
<b>Lidhja me fushat e tjera</b> <b>Histori, Arte, TIK</b>		<b>VLERËSIMI:</b> për përgjigjet në grup, punën e pavarur, diskutimet; vlerësimi ipunës së grupeve nga njëri-tjetri	
<b>Detyrat dhe puna e pavarur.</b> Sipas gjykimit dhe rezultateve të të nxënëtit që do të përcaktojmë për se cilën orë.			

Fusha e kurrikulës- Gjuhë dhe komunikim Shkalla e Kurrikulës/3/Klasa : VII Lënda : Gjuhë shqipe	
Tema mësimore: <b>Teksti letrar dhe Teksti joletrar</b>	
Njësia mësimore:Teksti joletrar	
<b>Materiale dhe mjete mësimore</b> Teksti mësimor <i>Gjuha shqipe</i> 7, fotografji, njohuritë e nnxënësit, interneti,etj	<b>Metoda dhe teknika mësimore.</b> stuhi mendimi, diagrami i Venit, bashkëbisedim, punë e pavarur,
<b>Përdorimi i teknologjisë informative :</b>	
<b>Kontributi në kompetencat kryesore :</b>	
1 <b>Kompetenca komunikim dhe të shprehur -- Komunikues efektiv</b>	1,2,3,4,5,6,7,8
| - Nënvizohen fjalët kyç të paragrafëve |   |

kryesorë.

Përbledhja përbëhet prej tri pjesësh:

**Hyrja**

i shpjegon lexuesit se çfarë përmban dhe çfarë është e rëndësishme lidhur me temën

**Zhvillimi**

ose përbajtja shpjegon shkurt rrjedhën e ngjarjeve me detajet më kryesore.

**Konkluzioni**

jep përfundimet që merr rrjedha e ngjarjeve.

Përbledhja zakonisht shkruhet kur shkrimet janë shumë të gjata dhe lexuesit duan të mësojnë gjërat në mënyrë të përbledhur

**R $\square$ Të shkruajmë përbledhjen e një përralle**

E bija e hënës dhe e diellit

**Hyrja**

Ishte një nënë që kishte një djali të vetëm. Kur djali u nis për gjah, nëna e porositi të mos shkonte në malin ku ishte kuçedra. Djali nuk dëgjoi nënën, por vashën e zemrës, e cila këmbënguli që ai të shkonte te mali i rezikshëm.

**Zhvillimi**

Djali dëgjoi të dashurën dhe u nis për gjah në malin ku ishte kuçedra. Atje u përball me kuçedrën, e cila e çarmatosi dhe e detyroi të dorëzohej. Djali i kërkoi kuçedrës ta lejonte të shkonte për të përshëndetur nënën dhe të dashurën, duke i lënë si premtim Besën.

Pasi u bind, kuçedra e la djalin të përshëndetet për herë të fundit me nënën dhe vashën. Nëna ia dha kujës, kurse vasha i tha trimit se do ta shoqëronte deri në malin e kuçedrës. Kuçedra në fillim u gëzua kur e pa djalin e vashën. Por vetëm me një të parë vasha e mbërtheu kuçedrën në vend. Djali e kuptoi se ajo nuk ishte një vashë e zakonshme. Ajo ishte e bija e hënës dhe e diellit, që mbante në trup fuqinë e tyre

**Mbyllja**

Vasha u martua me djalin, sepse e kuptoi që ai e donte me të vërtetë dhe ishte trim e i besës. Kuçedra nuk doli më në sipërfaqe të dheut dhe në mal filloj të lulëzonte përsëri jeta.

**LIDHJA ME FUSHAT E TJERA:**

**VLERËSIMI:**

Nxënësit vlerësohen për realizimin e permbledhjes

**DETYRË SHTËPIE :**

**Teksti dhe konteksti.**

Fusha e kurrikulës- Gjuhë dhe komunikim Shkalla e Kurrikulës/3/Klasa : VII Lënda : Gjuhë shqipe		
Tema mësimore: Teksti dhe konteksti		
<b>Materiale dhe mjete mësimore</b> Teksti mësimor <i>Gjuha shqipe 7</i> , fjalorë, tekste të ndryshme	<b>Metoda dhe teknika mësimore.</b> <i>Diskutim, INSERT, punë e pavarur</i>	
<b>Përdorimi i teknologjisë informative :</b>		
<b>Kontributi në kompetencat kryesore :</b>		
1	<b>Kompetenca komunikim dhe të shprehur -- Komunikues efektiv</b>	1,2,3,4,5,6,7,8
2	<b>Kompetenca të të menduarit -- Mendimtar kreativ dhe kritik</b>	1,2,3,4,5,6,7,8
3	<b>Kompetenca të të mësuarit për të nxënë- Nxënës i suksesshëm</b>	1,2,3,4,5,6,7
4	<b>Kompetenca për jetë, punë dhe mjedis - Kontribues produktiv</b>	1,2,3,4,5,6,7,8
5	<b>Kompetenca personale - Individ i shëndoshë</b>	1,2,3,4,5,6,7,8,9,10
6	<b>Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm</b>	1,2,3,4,5,6,7,8
<b>Fjalët kyçë:</b> tekst,kontekst,fjalë,situate,rrethanë		
<b>Rezultatet e të nxënëtit.</b> <b>Njohuri gjuhësore:</b> Aftësi komunikuese -Drejtohen dhe shprehen në mënyrë adekuate nëpërmjet gjuhës së folur dhe të shkruar <b>Shkathësi:</b> Të zgjidhurit e problemeve -Gjykojnë në mënyrë kritike dhe janë kreativë <b>Sjellje:</b> Puna grupore, <b>Qëndrime :</b> Vetëvlerësimi <b>Vlera:</b> Puna grupore, Kreativiteti, Të menduarit kritik <b>Shprehi :</b> Të lexuarit, Të shkruarit <b>Kriteret e suksesit-Rezultate</b> Nxënësi/ja: - dallon kuptimin e fjalëve tekst dhe kontekst - diskuton për tekstin dhe kontekstin e një vepre të lexuar - analizon veprën nga teksti dhe konteksti i zhvillimit të ngjarjeve		
<b>ZHVILLIMI I MËSIMIT</b>		
<b>E <input type="checkbox"/> Diskutim</b>		

Mësuesi/ja organizon mësimin me pyetjen :

Ç'kuptoni me fjalën tekst?

Ç'kuptoni me fjalën kontekst?

Nxënësit lejohen të shprehin lirisht mendimet e tyre. Lejohen dhe diskutime mes nxënësve.

**R  INSERT**

Mësuesi/ja fillon mësimin duke prezantuar pjesën Teksti dhe konteksti nga libri Gjuha shqipe 7, fq.48.

Udhëzohen nxënësit që gjatë leximit të përdoren shenjat INSERT dhe më pas ta plotësojnë tabelën INSERT

V	+	-	?
Njohuritë e reja      që	Njohuritë e reja      që	Njohuritë e reja që bien	Njohuritë e reja që
nxënësi i di që më parë	nxënësi    i kupton	ndesh    me ato njohuri që nxënësi mendon se i ka ditur	nxënësi nuk       i kupton

**R  Punë në dyshe**

Pas plotësimit të tabelës, nxënësit në dyshe diskutojnë për informacionet e tyre të vendosura në tabelën INSERT

<b>LIDHJA ME FUSHAT E TJERA:</b> Shkencë, letërsi, arte	<b>VLERËSIMI:</b> Vlerësim i vazhdueshëm
<b>DETYRË SHTËPIE :</b> <b>punë e diferençuar</b>	

Llojet e poezisë lirike (**himni, ditirambi, odja, elegja**).

Fusha e kurrikulës- Gjuhë dhe komunikim Shkalla e Kurrikulës/3/Klasa : VII Lënda : Gjuhë shqipe	Tema mësimore: Llojet e poezisë lirike
<b><u>Materiale dhe mjete mësimore</u></b> Teksti mësimor <i>Gjuha shqipe 7,</i>	<b><u>Metoda dhe teknika mësimore.</u></b> Prezantim digjital, pema e mendimit, mendo/puno në dyshe/thuaja tjetrit, diskutim
<b>Përdorimi i teknologjisë informative :</b>	

**Kontributi në kompetencat kryesore :**

1	<b>Kompetenca komunikim dhe të shprehur -- Komunikues efektiv</b>	1,2,3,4,5,6,7,8
2	<b>Kompetenca të të menduarit -- Mendimtar kreativ dhe kritik</b>	1,2,3,4,5,6,7,8
3	<b>Kompetenca të të mësuarit për të nxënë- Nxënës i suksesshëm</b>	1,2,3,4,5,6,7
4	<b>Kompetenca për jetë, punë dhe mjedis - Kontribues produktiv</b>	1,2,3,4,5,6,7,8
5	<b>Kompetenca personale - Individ i shëndoshë</b>	1,2,3,4,5,6,7,8,9,10
6	<b>Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm</b>	1,2,3,4,5,6,7,8

Fjalët kyçë: :

**Rezultatet e të nxënëtit.**

**Njohuri gjuhësore:** Aftësi komunikuese

-Drejtohen dhe shprehen në mënyrë adekuate nëpërmjet gjuhës së folur dhe të shkruar

**Shkathtësi :**Të zgjidhurit e problemeve

-Gjykojnë në mënyrë kritike dhe janë kreativë

**Sjellje:**

Puna grupore,

**Qëndrime:**

Vetëvlerësimi

**Vlera:**

Puna grupore, Kreativiteti, Të menduarit kritik

**Shprehi :**

Të lexuarit, Të shkruarit

**Kriteret e suksesit - Rezultate**

Nxënësi/ja:

- lidh idetë dhe informacionin e tekstit me njohuritë, përvojën ose leximet e mëparshme;

-kërkon informacion përfjalët e panjohura dhe mëson t'i përdorë ato;

-dallon llojet e poezisë lirike kur lexon ose dëgjon poezi

**ZHVILLIMI I MËSIMIT**

**E  Stuhi mendimi**

Kërkohet nga nxënësit që të recitojnë poezi të ndryshme të cilat i kanë mësuar më herët, duke i veçuar ato poezi lirike.

Për poezitë e veçuara i pyesim nxënësit se çfarë tematikash kanë këto poezi?

I njohim nxënësit me temën, dhe i udhëzojmë që t'i hapin librat faqe,53

**R  Ditari dypjesësh-Bashkëbisedim**

Nxënësit udhëzohen që në heshtje ta lexojnë tekstin dhe në ditarin dypjesësh t'i shënojnë karakteristikat e himnit,odjes dhe ditirambit, kurse në anën e djathtë komentojnë këto lloje poezish. Mund të shkruajnë edhe tituj të ndonjë pozie te lloji përkatës.

**R Tabelë krahasimi**

Krahasojnë këto tri llojesh të poezisë duke treguar për secilën veçoritë e saj

**LIDHJA ME FUSHAT E TJERA:**  
Histori, letërsi, art, gazetari,etj

**VLERËSIMI:**  
Vlerësim i vazhdueshëm

**DETÝRË SHTËPIE :**  
**punë e diferencuar**

**Fusha e kurrikulës- Gjuhë dhe komunikim  
Shkalla e Kurrikulës/3/Klasse VII  
Lënda : Gjuhë shqipe**

Tema mësimore: Pamje-AsdreniTekst letrar (ora I)

<u>Materiale dhe mjete mësimore</u>	<u>Metoda dhe teknika mësimore.</u>
Poezia "Pamje"-Asdreni	Stuhi mendimesh,Ditar dypjesësh,Shkrim i lirë

**Përdorimi i teknologjisë informative :**

**Kontributi në kompetencat kryesore :**

1	<b>Kompetenca komunikim dhe të shprehur -- Komunikues efektiv</b>	1,2,3,4,5, <b>6,7,8</b>
2	<b>Kompetenca të të menduarit -- Mendimtar kreativ dhe kritik</b>	1,2,3, <b>4,5,6,7,8</b>
3	<b>Kompetenca të të mësuarit për të nxënë - Nxënës i suksesshëm</b>	1,2,3,4,5,6,7
4	<b>Kompetenca për jetë, punë dhe mijedis - Kontribues produktiv</b>	1,2,3, <b>4,5,6,7,8</b>
5	<b>Kompetenca personale - Individ i shëndoshë</b>	1,2,3,4,5,6,7, <b>8,9,10</b>
6	<b>Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm</b>	1,2,3,4, <b>5,6,7,8</b>

**Fjalët kyçë:** natyra, lindja e diellit, perëndimi, ndjenja

**Rezultatet e të nxënët.**

**Njohuri gjuhësore:** Aftësi komunikuese

- Komunikon mirë

**Shkathtësi :** Të zgjidhurit e problemeve

-Gjykojnë në mënyrë kritike dhe janë kreativë

**Sjellje:**

Tregojne vetëbesimin për punë të pavarrur

**Qëndrime :**

Vetëvlerësimi

**Vlera:**

Përdorin imagjinatën dhe kreativitetin

**Shprehi :**

Të lexuarit, Të shkruarit

**Kriteret e suksesit-Resultate**

- Interpreton bukur poezinë
- Analizon gjuhën e përdorur në poezi
- Shkruan përjetimet e tij në një nga çastet e perëndimit të diellit

## ZHVILLIMI I MËSIMIT

### **E □ Stuhi mendimesh**

Së pari mësuesi/ja kërkon nga nxënësit që ta përshkruajnë një ditë të bukur me diell, sidomos momentet e perëndimit të diellit

### **R □ Ditari dypjesësh**

Mësuesi/ja i njofton me temën dhe shkurtimisht i njofton se leximin do ta bëjnë në heshtje dhe pastaj do të përzgjedhin pjesët që u kanë bërë më shumë mbresa t'i shkruajnë ë ditarin dypjesësh dhe t' komentojnë ato. -Çfarë ju bëri t'i përzgjidhni ato pjesë, si u ndjetë në ato moment, çfarë ju kujtoi, etj.

Pjesë nga teksti

Komentet

I

II

III

### **R□Shkrim i lirë**

Si e përfytyron poeti diellin: siç është në jetë apo si një qenie me shpirt? Gjeni ato vargje që ilustrojnë mendimin tuaj dhe shkruani ato.

**LIDHJA ME FUSHAT E TJERA:**

**VLERËSIMI:**

Sipas gjykimit të mësuesit,  
vetëvlerësim

**DETÝRË SHTËPIE :** Të shkruajnë, “Çasti më i bukur i ditës, perëndimit të diellit”

### **Fusha e kurrikulës - Gjuhë dhe komunikim**

**Shkalla e Kurrikulës/3/Klaza VII**

**Lënda : Gjuhë shqipe**

Tema mësimore: Pamje-Asdreni (tekst letrar ora II)

#### **Materiale dhe mjete mësimore**

Teksti “Pamje”-Asdreni,përvoja të nxënësve

#### **Metoda dhe teknika mësimore.**

pyetje-përgjigje,diskutim,shkrim i lirë

#### **Përdorimi i teknologjisë informative :**

#### **Kontributi në kompetencat kryesore :**

1	<b>Kompetenca komunikim dhe të shprehur -- Komunikues efektiv</b>	1,2,3,4,5,6,7,8
2	<b>Kompetenca të të menduarit -- Mendimtar kreativ dhe kritik</b>	1,2,3,4,5,6,7,8
3	<b>Kompetenca të të mësuarit për të nxënë- Nxënës i suksesshëm</b>	1,2,3,4,5,6,7
4	<b>Kompetenca për jetë, punë dhe mjesdis</b>	1,2,3,4,5,6,7,8

	<b>- Kontribues produktiv</b>	
5	<b>Kompetenca personale - Individ i shëndoshë</b>	<b>1,2,3,4,5,6,7,8,9,10</b>
6	<b>Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm</b>	<b>1,2,3,4,5,6,7,8</b>
<b>Fjalët kyçë:</b> dramë, tregim, përshtat, personazhe, ligjëratë e drejtë, ligjëratë e zhdrejtë		
<p><b>Rezultatet e të nxënëtit.</b></p> <p><b>Njohuri gjuhësore:</b> Aftësi komunikuese</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Komunikon mirë</li> </ul> <p><b>Shkathësi :</b> Të zgjidhurit e problemeve</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Gjykojnë në mënyrë kritike dhe janë kreativë</li> </ul> <p><b>Sjellje:</b></p> <p>Tregojne vetëbesimin për punë të pavarur</p> <p><b>Qëndrime :</b></p> <p>Vetëvlerësimi</p> <p><b>Vlera:</b></p> <p>Përdorin imagjinatën dhe kreativitetin</p> <p><b>Shprehi :</b></p> <p>Të lexuarit, Të shkruarit</p>		
<p><b>Kriteret e suksesit-Rezultate</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- komenton fragmente nga poezia me ditarët e të nxënëtit</li> <li>- analizon gjuhën dhe stilin e autorit në këtë poezi</li> <li>- argumenton mendimin e tij, i pavarur nga teksti</li> </ul>		
<b>ZHVILLIMI I MËSIMIT</b>		
<p><b>E □ Stuhi mendimesh-Pyetje-përgjigje</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Për ç'dukuri natyrore flet poeti në këtë vjershë?</li> <li>2. Në këtë vjershë poeti nuk është vetëm një soditës i peizazhit. Cilat janë ndjesitë që e kanë pushtuar poetin në këto çaste? <ul style="list-style-type: none"> <li>- Habija,</li> <li>- dhimbja,</li> <li>- indiferenca,</li> <li>- admirimi,</li> <li>- mospëlqimi</li> </ul> </li> <li>3. Po juve çfarë ndjesish ju lindin gjatë perëndimit të diellit? A ndieni që t'ju pasurohen ato, pasi lexuat këtë poezi?</li> </ol>		
<p><b>R □ Diskutim</b></p> <p>-Çfigura stilistike përdorë poeti në këtë poezi?</p> <p>Nxënësit diskutojnë për figurat letrare.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Gjeni krahasimin me të cilin poeti e përshkruan diellin në çastin e perëndimit.</li> <li>- Cila është ngjyra kryesore me të cilën piktori do ta pikturonte këtë peizazh?</li> <li>- Ndaluni në marrëdhëni që krijon poeti:</li> </ul> <p>E kuqja,</p> <p>Perëndimi,</p>		

<p>Gjaku</p> <p>Cila ndodhë vërtetë në natyrë?</p> <p>Cila ndodh në imaginatën e poetit?</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Me ç'hollësi e jep poeti përhapjen e përskuqjes së diellit: p.sh. U skuqën ujrat dhe toka</li> <li>- Krasimi i zgjeruar në vargun e fundit: sikur prej dore magjistari t'ishin ndërruar të nxit imaginatën dhe të shton habinë që të shkakton ndërrimi dhe bukuria e natyrës.</li> </ul> <p>A e keni menduar ndonjëherë pér këtë? Në ç'mënyrë? Nëse jo, le t'ju shërbejë kjo poezi pér të pasuruar fantazinë dhe mendimin tuaj.</p>
<b>R<small>esultat</small> Sh<small>krim</small> i l<small>ire</small></b>
Përpjuni t'i ktheni varjet në prozë duke ruajtur sa më shumë origjinalitetin e tyre. Përfytyroni disa dukuri të natyrës duke i shpirtëzuar: P.sh., lumi si gjarpër, gjethet e pemëve pëshpërisin, hëna buzëqesh etj

<b>Fusha e kurrikulës- Gjuhë dhe komunikim</b> <b>Shkalla e Kurrikulës/3/Klasse VII</b> <b>Lënda : Gjuhë shqipe</b>		
Tema mësimore: "Gjuha shqipe" Gjergj Fishta-Poezi (ora I)		
<b>Materiale dhe mjetë mësimore</b> Poezia "Gjuha shqipe"-Gjergj Fishta,përvoja e nxënësve	<b>Metoda dhe teknika mësimore.</b> Pema e mendimit, Ruaje fjalën e fundit pér mua, diskutim, bashkëbisedim	
<b>Përdorimi i teknologjisë informative :</b>		
<b>Kontributi në kompetencat kryesore :</b>		
1	<b>Kompetenca komunikim dhe të shprehur -- Komunikues efektiv</b>	1,2,3,4,5, <b>6</b> ,7,8
2	<b>Kompetenca të të menduarit -- Mendimtar kreativ dhe kritik</b>	1,2,3, <b>4</b> ,5,6,7,8
3	<b>Kompetenca të të mësuarit pér të nxënë- Nxënës i suksesshëm</b>	1,2,3,4,5,6,7
4	<b>Kompetenca pér jetë, punë dhe mjedis - Kontribues produktiv</b>	1,2,3, <b>4</b> ,5,6,7,8
5	<b>Kompetenca personale - Individ i shëndoshë</b>	1,2,3,4,5,6,7,8,9,10
6	<b>Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm</b>	1,2,3,4, <b>5</b> ,6,7,8

<b>Fjalët kyçë:</b> gjuha shqipe, e bukur, e zjarritë, këngë zogjsh, ushtimë termeti
<b>Rezultatet e të nxënët.</b>
Njohuri gjuhësore: Aftësi komunikuese - Komunikon mirë Shkathtesi :Të zgjidhurit e problemeve

-Gjykojnë në mënyrë kritike dhe janë kreativë

**Sjellje:**

Tregojne vetëbesimin për punë të pavarur

**Qëndrime :**

Vetëvlerësimi

**Vlera:**

Përdorin imagjinatën dhe kreativitetin

**Shprehi :**

Të lexuarit, Të shkruarit


**Kriteret e suksesit-Rezultate**

- Lexon dhe interpreton bukur poezinë
- Analizon dhe komenton gjuhën e tekstit dhe përbajtjen
- Diskuton për bukurinë e gjuhës dhe shtrirjen gjeografike të saj

**ZHVILLIMI I MËSIMIT**

**E □ Pema e mendimeve**

Së pari mësuesi/ja kërkon nga nxënësit që të krijojnë një pemë të mendimeve me ide për gjuhën shqipe, duke i kategorizuar idetë e tyre



**R □ Ruaje fjalën e fundit për mua/diskutim**

Mësuesi/ja i njofton nxënësit me temën dhe autorin, duke shtuar se ashtu si Naim Frashëri edhe Gjergj Fishta mbahet si poeti kombëtar i shqipes, që shkroi epopenë shqiptare në vargje dhe që gjithnjë punoi e luftoi për idenë lartësimit të gjuhës e të kombit shqiptarë

Lexohet dy here poezia nga nxënësit dhe pastaj u kërkohet nxënësve të përzgjedhin vetëm një pjesë nga poezia qqë iu pëlqen më shumë, e shkruajnë në një skedë. Nga ana tjetër e skedës komentohet pjesa.

Mësuesi/ja mbledh të gjitha skedat, në mënyrë të rastësishme përzgjedhë një të, lexon pjesën e përzgjedhur dhe pastaj hap diskutimin për atë pjesë. Në fund jep komentin nxënësi që e ka shkruar atë dhe mbyllët diskutimi për atë skedë. Vazhdohet me tjetrën.

**R □ Bashkëbisedim**

Bashkëbisedim në klasë për këto dy qëndrime të Fishtës:

- Lavdërimin e gjuhës shqipe
- Mallkimin e atyre që e mohojnë

**LIDHJA ME FUSHAT E TJERA:**

Ed.qytetare, histori

**VLERËSIMI:**

Sipas gjykimit të mësuesit,  
vetëvlerësim

**DETÝRË SHTËPIE :** Ta mësojnë përmendësh poezinë

**Fusha e kurrikulës- Gjuhë dhe komunikim****Shkalla e Kurrikulës/3/Klasa VII****Lënda : Gjuhë shqipe**

Tema mësimore: "Gjuha shqipe"Gjergj Fishta-Poezi (ora II)

**Materiale dhe mjete mësimore**

Poezia "Gjuha shqipe"-Gjergj Fishta,përvoja e nxënësve

**Metoda dhe teknika mësimore.**

Bashkëbisedim

**Përdorimi i teknologjisë informative :****Kontributi në kompetencat kryesore :**

1	<b>Kompetenca komunikim dhe të shprehur -- Komunikues efektiv</b>	1,2,3,4,5, <b>6,7,8</b>
2	<b>Kompetenca të të menduarit -- Mendimtar kreativ dhe kritik</b>	1,2,3, <b>4,5,6,7,8</b>
3	<b>Kompetenca të të mësuarit për të nxënës- Nxënës i suksesshëm</b>	1,2,3,4,5,6,7
4	<b>Kompetenca për jetë, punë dhe mjedis - Kontribues produktiv</b>	1,2,3, <b>4,5,6,7,8</b>
5	<b>Kompetenca personale - Individ i shëndoshë</b>	1,2,3,4,5,6,7, <b>8,9,10</b>
6	<b>Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm</b>	1,2,3,4,5,6,7, <b>8</b>

Fjalët kyçë:gjuha shqipe, e bukur, e zjarrtë, këngë zogjsh, ushtimë tërmjeti

**Rezultatet e të nxënës.****Njohuri gjuhësore:** Aftësi komunikuese

- Komunikon mirë

**Shkathtësi :**Të zgjidhurit e problemeve

-Gjykojnë në mënyrë kritike dhe janë kreativë

**Sjellje:**

Tregojne vetëbesimin për punë të pavarrur

**Qëndrime :**

Vetëvlerësimi

**Vlera:**

Përdorin imagjinatën dhe kreativitetin

**Shprehi :**

Të lexuarit, Të shkruarit

**Kriteret e suksesit-Resultate**

- Bashkëbisedon për ata që flasin dhe shkruajnë me shumë gabime gjuhën
- Krijon trungun familjar
- Komenton trungun familjar

**ZHVILLIMI I MËSIMIT****E  Bashkëbisedim**

Siç e dini, shumë familje shqiptare sot kanë emigruar dhe jetojnë në shtete të tjera të botës.

Fëmijët e këtyre familjeve rrezikojnë të harrojnë gjuhën shqipe. Ata flasin dhe shkruajnë me shumë gabime.

- A nuk është kjo një dukuri shumë negative? Pse?
  - Si mund të shmanget kjo gjë?
  - Cilët janë përgjegjësit kryesorë për këtë?
  - Me çka e krahason gjuhën shqipe poeti:
- 
- Gjeni mbiemrat e nyshmë që përdor poeti.
  - Pse ndodh kjo?
  - A mendoni se në këtë rast shtohet emocionaliteti i poeziës?

#### **R □ Skicim**

Ndaluni tek ideja e trashëgimisë. Le ta shohim atë në formën e skicës:

STËRGJYSHI-----BABAI-----FËMIJA –

Bëni pemën familjare dhe jepni komentin tuaj

#### **R □ Recitim**

Mësuesi/ja u kërkon nxënësve që të mundohen ta recitojnë sa më bukur atë

<b>LIDHJA ME FUSHAT E TJERA:</b> Ed.Qytetare, histori	<b>VLERËSIMI:</b> Sipas gjykimit të mësuesit, vetëvlerësim i vazhdueshëm
<b>DETÝRË SHTËPIE:</b>	

#### **Fusha e kurrikulës - Gjuhë dhe komunikim**

#### **Shkalla e Kurrikulës/3/Klaza VII**

**Lënda: Gjuhë shqipe**

Tema mësimore: “Mëngjes” Lasgush Poradeci-Poezi (ora I)

<b>Materiale dhe mjete mësimore</b> Poezia “Pamje”-Asdreni	<b>Metoda dhe teknika mësimore.</b> Stuhi mendimesh,Ditari dypjesësh,Shkrim i lirë
---	--

**Përdorimi i teknologjisë informative :**

**Kontributi në kompetencat kryesore :**

1	<b>Kompetenca komunikim dhe të shprehur -- Komunikues efektiv</b>	1,2,3,4,5,6,7,8
2	<b>Kompetenca të të menduarit -- Mendimtar kreativ dhe kritik</b>	1,2,3,4,5,6,7,8
3	<b>Kompetenca të të mësuarit për të nxënës- Nxënës i suksesshëm</b>	1,2,3,4,5,6,7
4	<b>Kompetenca për jetë, punë dhe mjedis - Kontribues produktiv</b>	1,2,3,4,5,6,7,8
5	<b>Kompetenca personale - Individ i shëndoshë</b>	1,2,3,4,5,6,7,8,9,10
6	<b>Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm</b>	1,2,3,4,5,6,7,8

**Fjalët kyçë:** mëngjes, natyra, lindja e diellit, ndjenja, lijeni

**Rezultatet e të nxënëtit.**

**Njohuri gjuhësore:** Aftësi komunikuese

- Komunikon mirë

**Shkathësi:** Të zgjidhurit e problemeve

-Gjykojnë në mënyrë kritike dhe janë kreativë

**Sjellje:**

Tregojne vetëbesimin për punë të pavarur

**Qëndrime :**

Vetëvlerësimi

**Vlera:**

Përdorin imagjinatën dhe kreativitetin

**Shprehi :**

Të lexuarit, Të shkruarit

#### **Kriteret e suksesit-Resultate**

- Interpreton bukur poezinë
- Analizon gjuhën e përdorur në poezi
- Shkruan përjetimet e tij në një nga vizitat në lige

#### **ZHVILLIMI I MËSIMIT**

##### **E □ Stuhi mendimesh**

Së pari mësuesi/ja kërkon nga nxënësit që ta përshkruajnë një ditë kur kanë vizituar një lige. Ta përshkruajnë liqenin,natyren,etj

##### **R □ Ditarri dypjesësh**

Mësuesi/ja i njofton me temën dhe shkurtimisht i njofton se leximin do ta bëjnë në heshtje dhe pastaj do të përzgjedhin pjesët që u kanë bërë më shumë mbresa t’l shkruajnë ë ditarin dypjesësh dhe t’ komentojnë ato. -Çfarë ju bëri t’i përzgjidhni ato pjesë, si u ndjetë në ato moment, Çfarë ju kujtoi, etj

Pjesë nga teksti

Komente

I

II

III

##### **R□Tabela**

Çfarë ju ngjall leximi i tri strofave të poeziës? Plotësoni me po ose jo pér secilën:

qetësi

Strofa I

Strofa II

Strofa III

gëzim

ëndërrim

entuziazëm	
frymëzim	
kënaqësi	
ankth	
frikë	
<b>LIDHJA ME FUSHAT E TJERA:</b>	<b>VLERËSIMI:</b> Sipas gjykimit të mësuesit, vetëvlerësim
<b>DETÝRË SHTËPIE :</b>	

<b>Fusha e kurrikulës- Gjuhë dhe komunikim</b> <b>Shkalla e Kurrikulës/3/Klasa VII</b> <b>Lënda : Gjuhë shqipe</b>																		
Tema mësimore:Mengjes-Lasgush Poradeci (poezi ora II)																		
<b>Materiale dhe mjetë mësimore</b> Teksti "Pamje"- Asdreni, përvoja të nxënësve	<b>Metoda dhe teknika mësimore.</b> Fjalë kyçe, pyetje-përgjigje, imagjinatë e drejtuar, diskutim, shkrim i lirë																	
<b>Përdorimi i teknologjisë informative :</b>																		
<b>Kontributi në kompetencat kryesore :</b>																		
<table border="1"> <tr> <td>1</td><td><b>Kompetenca komunikim dhe të shprehur -- Komunikues efektiv</b></td><td>1,2,3,4,5,<b>6,7,8</b></td></tr> <tr> <td>2</td><td><b>Kompetenca të të menduarit -- Mendimtar kreativ dhe kritik</b></td><td>1,2,3,4,5,6,7,8</td></tr> <tr> <td>3</td><td><b>Kompetenca të të mësuarit për të nxënë-Nxënës i sukseshtëm</b></td><td>1,2,3,4,5,6,7</td></tr> <tr> <td>4</td><td><b>Kompetenca për jetë, punë dhe mjedis - Kontribues produktiv</b></td><td>1,2,3,4,5,6,7,8</td></tr> <tr> <td>5</td><td><b>Kompetenca personale - Individ i shëndoshë</b></td><td>1,2,3,4,5,6,7,8,9,10</td></tr> <tr> <td>6</td><td><b>Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm</b></td><td>1,2,3,4,5,6,7,8</td></tr> </table>	1	<b>Kompetenca komunikim dhe të shprehur -- Komunikues efektiv</b>	1,2,3,4,5, <b>6,7,8</b>	2	<b>Kompetenca të të menduarit -- Mendimtar kreativ dhe kritik</b>	1,2,3,4,5,6,7,8	3	<b>Kompetenca të të mësuarit për të nxënë-Nxënës i sukseshtëm</b>	1,2,3,4,5,6,7	4	<b>Kompetenca për jetë, punë dhe mjedis - Kontribues produktiv</b>	1,2,3,4,5,6,7,8	5	<b>Kompetenca personale - Individ i shëndoshë</b>	1,2,3,4,5,6,7,8,9,10	6	<b>Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm</b>	1,2,3,4,5,6,7,8
1	<b>Kompetenca komunikim dhe të shprehur -- Komunikues efektiv</b>	1,2,3,4,5, <b>6,7,8</b>																
2	<b>Kompetenca të të menduarit -- Mendimtar kreativ dhe kritik</b>	1,2,3,4,5,6,7,8																
3	<b>Kompetenca të të mësuarit për të nxënë-Nxënës i sukseshtëm</b>	1,2,3,4,5,6,7																
4	<b>Kompetenca për jetë, punë dhe mjedis - Kontribues produktiv</b>	1,2,3,4,5,6,7,8																
5	<b>Kompetenca personale - Individ i shëndoshë</b>	1,2,3,4,5,6,7,8,9,10																
6	<b>Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm</b>	1,2,3,4,5,6,7,8																
<b>Fjalët kyçe:</b>																		
<b>Rezultatet e të nxënëtit.</b> <b>Njohuri gjuhësore:</b> Aftësi komunikuese - Komunikon mirë <b>Shkathtësi :</b> Të zgjidhurit e problemeve -Gjykojnë në mënyrë kritike dhe janë kreativë <b>Sjellje:</b> Tregojne vetëbesimin për punë të pavarur <b>Qëndrime:</b> Vetëvlerësimi <b>Vlera:</b>																		

Përdorin imagjinatën dhe kreativitetin

**Shprehi :**

Të lexuarit, Të shkruarit

**Kriteret e suksesit-Resultate**

- komenton fragmente nga poezia me ditarët e të nxënët
- analizon gjuhën dhe figurat stilistike në këtë poezi
- zbërthen kuptimin e figurshëm të fjalëve nga teksti


**ZHVILLIMI I MËSIMIT**

**E □ Fjalë kyçe**

1. Në të tria strofat e poesisë kemi tri çaste të ndryshme kohe:
  - nata
  - agimi (kufiri midis natës dhe mëngjesit)
  - ardhja e mëngjesit.Me cilat fjalë kyçe i përshkruan ato poeti? Gjejini dhe lexojini ato.  
2. Shkruani nga një fjali për secilën strofë.

**R □ Imagjinatë e drejtuar**

- Shpesh fjalën shpirt ne e përdorim me të njëjtin kuptim me fjalën zemër. P.sh.: më dhemb shpirti, më dhemb zemra, m'u gëzua shpirti, m'u gëzua zemra, duke shprehur kështu ato ndjenja që na burojnë nga brenda.



A ju pëlqen kjo? Pse?

- Gjeni krahasimin në strofën e fundit dhe thoni si e kuptoni atë.

**R□Diskutim**

1. Duke u mbështetur në kuptimin e parë të foljeve *shuaj* dhe *tret*, zbërtheni kuptimin e tyre të figurshëm dhe diskutojini ato p.sh.:

(kupt. i parë)	(kupt. i figur.)
- Po shuhet zjarri...	- Po shuhet nata...
- Po tretet kokrra e sheqerit (në ujë)	- Po tretet ylli i drithës (në liqen)
• Këto folje tregojnë për një veprim	
p të ngadalshëm	
p të shpejtë?	

**LIDHJA ME FUSHAT E TJERA:**

**VLERËSIMI:**

Sipas gjykimit të mësuesit, vetëvlerësim

**DETËRË SHTËPIE:** Pasi ta keni vëzguar me kujdes çastin e perëndimit të diellit, përshkruajeni atë bukur në fletoren tuaj. Mos harroni të vini re vendin ku perëndon dielli, lëvizjen, formën dhe ngjyrën që ndryshon.

### Si të shkruajmë ese

Fusha e kurrikulës- Gjuhë dhe komunikim

Shkalla e Kurrikulës/3/Klasa : VII

Lënda : Gjuhë shqipe

Tema mësimore: Si të shkruajmë ese

#### Materiale dhe mjete mësimore

Burimet: Teksti mësimor Gjuha shqipe 8, "Si të shkruajmë ese", Qendra për Arsim Demokratik

#### Metoda dhe teknika mësimore.

Brainstorming  
Shpjegim, bashkëbisedim, Prezantim

#### Përdorimi i teknologjisë informative :

#### Kontributi në kompetencat kryesore :

1	<b>Kompetenca komunikim dhe të shprehur -- Komunikues efektiv</b>	1,2,3,4,5,6,7,8
2	<b>Kompetenca të të menduarit -- Mendimtar kreativ dhe kritik</b>	1,2,3,4,5,6,7,8
3	<b>Kompetenca të të mësuarit për të nxënë - Nxënës i suksesshëm</b>	1,2,3,4,5,6,7
4	<b>Kompetenca për jetë, punë dhe mjeshtëri - Kontribues produktiv</b>	1,2,3,4,5,6,7,8
5	<b>Kompetenca personale - Individ i shëndoshë</b>	1,2,3,4,5,6,7,8,9,10
6	<b>Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm</b>	1,2,3,4,5,6,7,8

**Fjalët kyçë:** • ese përshkruese • tema • reflektim • ekzpoze • përshkrim, shpjegim • argumentim • narracion

#### Rezultatet e të nxënët.

**Njohuri gjuhësore:** Aftësi komunikuese

- Komunikon mirë

**Shkathtësi :** Të zgjidhurit e problemeve

-Gjykojnë në mënyrë kritike dhe janë kreativë

**Sjellje:**

Tregojne vetëbesimin për punë të pavavarur

**Qëndrime :**

Vetëvlerësimi

**Vlera:**

Përdorin imagjinatën dhe kreativitetin

**Shprehi :**

Të lexuarit, Të shkruarit

#### Kriteret e suksesit-Resultate

- njeh hapat që duhen ndjekur për të shkruar ese përshkruese
- dallon temën, propozimin, argumentet, provat qëvërtetojnë këto argumete, gjuhën e

përdorur, përfundimin në modelin e esesë së dhënë.

## **ZHVILLIMI I MËSIMIT**

### **E □ Brainstorming**

Nxënësit thonë çfarë ata dinë për esenë

Mësuesi bën shpjegimin e termit ese. Më pas jep dallimet mes shkrimit letrar dhe atij eseistik.

Këto mund të paraqiten në një tabelë në dërrasë të zezë.

Shkrimi letrar	Shkrimi eseistik
Trillim, fantazi.....	Të dhëna, informacione.....
.....	.....

### **R □ Shpjegim,bashkëbisedim**

Mësuesi u bën të ditur nxënësve llojet e esesë:

c)

-Ese historike, - letrare, - filozofike, - historike, etj

d)

Nisur nga mënyra e zhvillimit të përbajtjes kemi:

Ese përshkruese, - Ese shpjeguese, - Ese argumentuese , - Ese treguese.

Skema e esesë (skema klasike e esesë, ndërkokë që mund të procedohet edhe me numër më të madh paragrafësh).

Hyrja ( një paragraf ) Zhvillimi ( tre paragraf ) Mbyllja ( një paragraf )

Skedë punë

Plotësoni skemën e mëposhtme duke realizuar një ese përshkruese për njerëz.

Tema: Përshkrujeni shokun/shoqen tuaj më të ngushtë.

Hyrja ..... ( 1  
paragraf): ..... Prezantimi me  
personin ..... që do ta përshkruani  
..... Zhvillimi  
..... ( tre paragrafë): ...  
..... 1-përshkrimi i  
..... tipareve fizike  
.....

2-  
përshkrimi i tipareve  
..... Të  
karakterit; ..... si flet,  
gjestet, etj .....  
..... 3-të  
përbashkëtat ..... dhe dallimet  
..... mes jush  
..... Mbyllja

..... ( 1 paragraf: ..... Raporti që keni krijuar .....	
<b>R□Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. - 10'</b> Lexim i eseve	
LIDHJA ME FUSHAT E TJERA:	VLERËSIMI: <b>Vlerësohen esetë e shkruara</b>
<b>DETÝRË SHTËPIE :</b>	

## Kulture tradicionale (përralla, miti, figurat mitologjike, këngët e kreshnikeve, format e shkurtra)

Fusha e kurrikulës- Gjuhë dhe komunikim Shkalla e Kurrikulës/3/Klasa : VII Lënda : Gjuhë shqipe		
Tema mësimore: Kulture tradicionale		
<b>Materiale dhe mjete mësimore</b> Gjuha shqipe 7, tabela, shkumësi	<b>Metoda dhe teknika mësimore.</b> <i>Brainstorming</i> Shpjegim + diskutim Punë e pavarur	
<b>Përdorimi i teknologjisë informative :</b>		
<b>Kontributi në kompetencat kryesore :</b>		
1	<b>Kompetenca komunikim dhe të shprehur -- Komunikues efektiv</b>	1,2,3,4,5,6,7,8
2	<b>Kompetenca të tē menduarit -- Mendimtar kreativ dhe kritik</b>	1,2,3,4,5,6,7,8
3	<b>Kompetenca të tē mësuarit për tē nxënë- Nxënës i suksesshëm</b>	1,2,3,4,5,6,7
4	<b>Kompetenca për jetë, punë dhe mjedis - Kontribues produktiv</b>	1,2,3,4,5,6,7,8
5	<b>Kompetenca personale - Individ i shëndoshë</b>	1,2,3,4,5,6,7,8,9,10
6	<b>Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm</b>	1,2,3,4,5,6,7,8
<b>Fjalët kyçë:</b> : kulturë tradicionale, gojëdhëna, legjenda, përralla, ninulla,		
<b>Rezultatet e të nxënëtit.</b>		
<p><b>Njohuri gjuhësore:</b> Aftësi komunikuese          -Drejtohen dhe shprehen në mënyrë adekuate nëpërmjet gjuhës së folur dhe të shkruar  <b>Shkathtësi:</b> Të zgjidhurit e problemeve          -Zhvillon imaginatën dhe kreativitetin  <b>Sjellje:</b> Merr pjesë në diskutim  <b>Qëndrime:</b> Vetëvlerësimi  <b>Vlera:</b> Respekton mendimin e të tjerrëve  <b>Shprehi:</b> Të lexuarit, Të shkruarit</p>		
<p><b>Kriteret e suksesit-Resultate</b></p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Përcakton se ç’do të thotë kulturë tradicionale</li> <li>- Diskuton për një ninullë, një gojëdhënë, të cilat i përkasin krahasin ku jeton.</li> <li>- Plotëson tabelën me tituj që i përkasin llojit letrar të caktuar</li> </ul>		
<p>„</p> <p style="text-align: center;"><b>ZHVILLIMI I MËSIMIT</b></p> <p><b>E</b> <input type="checkbox"/> <b>Brainstorming</b></p> <p>Mësuesi/ja shkruan në tabelën e zezë fjalën Kulture tradicionale</p>		

Ai/ajo u drejtohet nxënësve: Ç’ dini ju pér këtë fjalë? Nxënësit shprehin mendimet e tyre. Më pas mësuesi shpjegon

Populli ka krijuar gjatë shekujve këngë, tregime, përralla, gojëdhëna, fjalë të urta, ninulla, lojëra, gjëegjëza, etj. Të gjitha këto futen në atë që quhet Kulturë tradicionale

**R  *Shpjegim + diskutim***

Më pas kalohet në diskutim:

Pse kultura tradicionale është një pjesë e rëndësishme e krijimtarisë popullore? Nxënësit shprehin mendimet e tyre, ndërkokë që mësuesi/ja edhe plotëson.duke thene se Kultura tradicionale pasuron vlerat kombëtare të një populli. Populli ynë ka krijime të ndryshme në prozë, siç janë përrallat, ku personazhet janë të ndryshme: Mbreti, djali i mbretit, E bukura e dheut, Zanat e Malit, Orët, Shtojzovallet, Djali jetim, Djali gjarpër, etj, Perrallat janë të ndryshme pér nga natyra dhe motivet.

Temat dhe motivet në përralla shqiptare janë të njëjtë apo të ngashme me temat apo motivet e përrallave europiane dhe aziatike, pra ato janë krijime më të vjetra popullore, që janë ruajtur dhe transmetuar brez pas brezi

**R  *Punë e pavarur***

Nga nxënësit kërkohet që të plotësojnë tabelën me tituj të krijimeve popullore nga ato që i dinë

Përrallë	
Gjëdhënë	
Fjalë të urta	
Ninulla	
Gjëegjëza	
Baladë	

<b>LIDHJA ME FUSHAT E TJERA:</b>	<b>VLERËSIMI:</b> Vlerëson nxënësit bazuar në përgjigjet e tyre, aktivizimin dhe përqëndrimin e tyre.
----------------------------------	--

<b>DETYRË SHTËPIE :</b> <b>punë e pavarur</b> Të shkruajnë një përrallë
--

IFusha e kurrikulës- Gjuhë dhe komunikim Shkalla e Kurrikulës/3/Klasa: VII Lënda: Gjuhë shqipe Tema mësimore: Përralla	<b>Materiale dhe mjete mësimore</b> Gjuhë shqipe dhe letërsi 7 Libri i përrallave,	<b>Metoda dhe teknika mësimore.</b> Bisedë e lirë; kllaster; leximi në dyshe,diskutim; punë e pavarur; punë dyshe; shkrim i lirë
<b>Përdorimi i teknologjisë informative :</b>		

**Kontributi në kompetencat kryesore :**

1	<b>Kompetenca komunikim dhe të shprehur -- Komunikues efektiv</b>	1,2,3,4,5,6,7,8
2	<b>Kompetenca të të menduarit -- Mendimtar kreativ dhe kritik</b>	1,2,3,4,5,6,7,8
3	<b>Kompetenca të të mësuarit për të nxënë- Nxënës i suksesshëm</b>	1,2,3,4,5,6,7
4	<b>Kompetenca për jetë, punë dhe mjedis - Kontribues produktiv</b>	1,2,3,4,5,6,7,8
5	<b>Kompetenca personale - Individ i shëndoshë</b>	1,2,3,4,5,6,7,8,9,10
6	<b>Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm</b>	1,2,3,4,5,6,7,8

**Fjalët kyçë:** : imagjinatë, shkrim, përrallë, hyrje, zhvillim, përfundim

**Rezultatet e të nxënëtit.**

**Njohuri gjuhësore:** Aftësi komunikuese

-Drejtohen dhe shprehen në mënyrë adekuate nëpërmjet gjuhës së folur dhe të shkruar

**Shkathësi:** Të zgjidhurit e problemeve

-Gjykojnë në mënyrë kritike dhe janë kreativë

**Sjellje:**

Puna grupore,

**Qëndrime:**

Vetëvlerësimi

**Vlera:**

Puna grupore, Kreativiteti, Të menduarit kritik

**Shprehi :**

Të lexuarit, Të shkruarit

**Kriteret e suksesit-Resultate**

Nxënësi/ja:

Dallon përrallën si lloj i tekstit letrar.

- Nxjerr në pah karakteristikat e përrallës nëpërmjet detajeve dhe fragmenteve në tekst.

- Analizon personazhet nëpërmjet fjalëve, veprimeve dhe mendimeve të tyre

„

**ZHVILLIMI I MËSIMIT**

**E □ Bisedë e lirë**

Nxënësve u shtrohen pyetjet: A ju pëlqejnë përrallat? Kur dhe nga kush keni dëgjuar përrallën e parë? A ju kujtohet ndonjë përrallë nga gjyshtërit, prindërit? Kush janë personazhe në përrallë?

**R □ Kllaster, Të lexuarit në dyshe**

nëpërmjet kllasterit, nxënësve u kërkohet të zbulojnë karakteristikat e përrallës

<p>Personazhe në përralla shqipe Zana,Ora,Shtojzovallet,Dragoi, Gjarpëri</p> <p>E jashtëzakonshmjë është Elementi kryesor i saj</p> <p>Gërsheton motivet reale me ato Fantastike</p> <p>Të lexuarit në dyshe</p> <p>Nxënësit punojnë në çifte,secili çift do ta ketë një numër nga 1-7. U caktohen detyra: dyshet me nr1..do ta lexojnë pjesën nga teksti përralla, dyshet me nr.2pjesën Figurat mitologjike, 3-shet zana, 4-shet,ora,5-shet,shtojzovallet,6-shet Dragoi dhe dyshet me numrin 7 Gjarpri.Secila pjese e tekstit do të kete ndarje, ku brenda dysheve nxënësit do te kene dy role:Raportuesi dhe Përgjigjedhënsi.Dyshet para klasës do ta zgjedhin vete mënyrën se si do ta paraqesin pjesën e caktuar. Aktivitetet përfundojnë kur të gjitha dyshet sqarojnë para klasës për pjesën që kanë pasur.</p>	<p>PËRRALLA</p>	<p>Krijim gojor</p> <p>E pamundura bëhet e mundur</p> <p>Bart vlera edukative Tregohet në prozë</p> <p>Gërsheton motivet reale me ato Fantastike</p> <p>Të lexuarit në dyshe</p>
<p><b>R<small>□</small>Shkrim i lirë</b></p> <p>Në mënyrë individuale nxënësit do të shkruajnë se çfarë mbajtën mend për përrallën dhe figurat mitologjike të përrallës.</p>		
<p><b>LIDHJA ME FUSHAT E TJERA:</b> Shoqëria dhe mjedis</p>		<p><b>VLERËSIMI:</b> Bëhet vlerësimi i vazhdueshëm i nxënësve në të gjithë hapat e orës mësimore.</p>
<p><b>DETÝRË SHTËPIE :</b> Detyrat dhe puna e pavarur: Gjeni dhe sillni në klasë përralla të tjera, të cilat i vlerësoni për mesazhet e rëndësishme që përcjellin.</p>		

<p>Fusha e kurrikulës- Gjuhë dhe komunikim Shkalla e Kurrikulës/3/Klasa: VII Lënda: Gjuhë shqipe</p> <p>Tema: Kulturë tradicionale Tema: Fabula "Ujku dhe qengji"</p>		
<p><b>Materiale dhe mjetë mësimore</b> Teksti mësimor <i>Gjuha shqipe</i> 7, interneti,vizatime,njohuritë e nnxënësit, fabula, anekdota dhe përralla të regjistruar,etj</p>		<p><b>Metoda dhe teknika mësimore.</b> DLTA, -diagrami i Venit, rrjeti i diskutimit, punë në grupe.</p>
<p><b>Përdorimi i teknologjisë informative : interneti</b></p>		
<p><b>Kontributi në kompetencat kryesore :</b></p>		
1	<b>Kompetenca komunikim dhe të shprehur -- Komunikues efektiv</b>	1,2,3,4,5,6,7,8
2	<b>Kompetenca të të menduarit -- Mendimtar kreativ dhe kritik</b>	1,2,3,4,5,6,7,8
3	<b>Kompetenca të të mësuarit për të nxënë- Nxënës i suksesshëm</b>	1,2,3,4,5,6,7
4	<b>Kompetenca për jetë, punë dhe mjedis -</b>	1,2,3,4,5,6,7,8

	<b>Kontribues produktiv</b>	
5	<b>Kompetenca personale - Individ i shëndoshë</b>	1,2,3,4,5,6,7,8,9,10
6	<b>Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm</b>	1,2,3,4,5,6,7,8

**Fjalët kyçë:** : fabula, tregojmë, dëgjojmë, rend logjik, mbyllje, zgjidhje

#### **Rezultatet e të nxënëtit.**

**Njohuri gjuhësore:** Aftësi komunikuese

-Drejtohen dhe shprehen në mënyrë adekuate nëpërmjet gjuhës së folur dhe të shkruar

**Shkathtësi :**Të zgjidhurit e problemeve

-Gjykojnë në mënyrë kritike dhe janë kreativë

**Sjellje:** Puna grupore,

**Qëndrime:** Vetëvlerësimi

**Vlera:** Puna grupore, Kreativiteti, Të menduarit kritik

**Shprehi:** Të lexuarit, Të shkruarit

#### **Kriteret e suksesit-Rezultate**

Nxënësi/ja:

- Fabulen e dëgjon dhe e tregon me vëmendje
- Shpreh mendimin e tij rreth tekstit që dëgjon
- Tregon anegdota për të tjerët
- Dallon anekdotën, fabulen, përrallën

### **ZHVILLIMI I MËSIMIT**

#### **E □ Stuhi mendimi**

Shfaqet fabula “Ujku dhe qengji”, e regjistruar

ose nga Youtube <https://www.youtube.com/éatch?v=fdfex3rPMDk>. Nxënësit e ndjekin me vëmendje.

Mësimdhënësi kërkon që nxënësit të përgjigjen se cilit lloj i përket ky tregim: përrallë, anekdotë apo fabulë.

Paraqiten fotografi të ndryshme të kësaj fabule





**R  Diskutim**

Nxënësit/et vërejnë me kujdes pamjet për fabulën dhe duhet ta tregojnë atë në forma të ndryshme.

Mësimdhënësi i orienton me pyetje, si:

-Si paraqitet ujku në këto fotografi?

-A është frikësuar qengji? Pse?

-Ju pëlqeu më shumë videoinçizimi apo fotografitë? Pse

**R  Punë në grupe/ diagram i Venit**

Nxënësit të ndarë në grupe me nga 4-5 anëtarësh. Secili grup do ta ritregojë fabulën në bazë të fotografive që panë ose tregimit të ndonjë nxënësi/se, ose nga videoinçizimi. Krahasohen fabula, përralla dhe anekdota me diagram të Venit.

**LIDHJA ME FUSHAT E TJERA:**

TIK

**VLERËSIMI:**

**DETÝRË SHTËPIE :**  
**punë e diferençuar**

Fusha e kurrikulës- Gjuhë dhe komunikim

Shkalla e Kurrikulës/3/Klasa : VII

Lënda : Gjuhë shqipe

Tema mësimore: Të shkruajmë përrallë

**Materiale dhe mjete mësimore**

Tabela e zezë, shkumësa, gjuha shqipe 7

**Metoda dhe teknika mësimore.**

Stuhi mendimesh

Praktikë e udhëhequr, shkrim i lirë  
diskutim

**Përdorimi i teknologjisë informative :**

**Kontributi në kompetencat kryesore :**

1 **Kompetenca komunikim dhe të shprehur -- Komunikues efektiv** 1,2,3,4,5,6,7,8

2 **Kompetenca të të menduarit -- Mendimtar kreativ dhe kritik** 1,2,3,4,5,6,7,8

<p>3 <b>Kompetenca të të mësuarit për të nxënës- Nxënës i suksesshëm</b></p> <p>4 <b>Kompetenca për jetë, punë dhe mijedis - Kontribues produktiv</b></p> <p>5 <b>Kompetenca personale - Individ i shëndoshë</b></p> <p>6 <b>Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm</b></p>	<p>1,2,3,4,5,6,7</p> <p>1,2,3,4,5,6,7,8</p> <p>1,2,3,4,5,6,7,8,9,10</p> <p>1,2,3,4,5,6,7,8</p>
<b>Fjalët kyçe:</b> : përrallë, strukturë, hyrje, përfundim, personazhe, mesazh, krijime popullore	
<b>Rezultatet e të nxënës.</b>	
<p><b>Njohuri gjuhësore:</b> Aftësi komunikuese            -Drejtohen dhe shprehen në mënyrë adekuate nëpërmjet gjuhës së folur dhe të shkruar</p> <p><b>Shkathtësi :</b>Të zgjidhurit e problemeve            -Zhvillon imaginatën dhe kreativitetin</p> <p><b>Sjellje:</b> Merr pjesë në diskutim</p> <p><b>Qëndrime:</b> Vetëvlerësimi</p> <p><b>Vlera:</b> Respekton mendimin e të tjerve</p> <p><b>Shprehi:</b> Të lexuarit, Të shkruarit</p>	
<p><b>Kriteret e suksesit-Resultate</b></p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Shkruan një përrallë duke respektuar elementet e saj.</li> </ul>	
<p>„</p> <p style="text-align: center;"><b>ZHVILLIMI I MËSIMIT</b></p> <p><b>E <input type="checkbox"/> Stuhi mendimesh</b>            Ju keni dëgjuar dhe lexuar përralla të ndryshme, thoni si fillojnë dhe si mbarojnë ato?</p> <p><b>R <input type="checkbox"/> Praktikë e udhëhequr,shkrim i lirë</b>            Mësuesi/ja e kthen vëmendjen e nxënësve te përralla e punuar në orët e kaluara dhe u kërkon të ndalen në hyrjen dhe mbylljen e saj. Si fillon përralla? Si mbylljet përralla? A ka fund të lumtur, si ndodh shpeshherë në përralla? A e keni vënë re këtë edhe në përralla të tjera që keni lexuar ose dëgjuar?            Mësuesi jep informacion më të zgjeruar në lidhje me përrallën, strukturën e saj            . - Si ndërtohet hyrja: Në hyrje të përrallës paraqiten shkurt personazhet, disa të dhëna kryesore rrëth tyre. - Zhvillimi i përrallës: Gjatë zhvillimit të përrallës njihemi me raportet midis personazheve, veprimet e tyre, rrjedhën e ngjarjeve, konfliktin dhe pikat nëpër të cilat kalon ai. - Mbyllja: Mbyllja e përrallave është gjithmonë me fund të lumtur, ku e mira mbizotëron mbi të keqen.</p> <p>-Nxënësit do të shkruajnë një përrallë duke patur parasysh çka kanë mësuar më parë.</p> <p><b>R <input type="checkbox"/> Diskutim</b>            Nxënësit do të shkruajnë mesazhin që duan të transmetojnë me anë të përrallës që shkruan.            Disa nxënës lexojnë në klasë përrallën që shkruan.            Diskutohen shkrimet dhe mesazhet e përrallave të krijuara.</p>	
<b>LIDHJA ME FUSHAT E TJERA:</b>	<b>VLERËSIMI:</b> Vlerëson nxënësit bazuar në shkrimin e lirë dhe mesazhin që përcjell.

**DETYRË SHTËPIE :**  
Përshtypjet për fragmentin e lexuar

<p>Fusha e kurrikulës- Gjuhë dhe komunikim          Shkalla e Kurrikulës/3/Klasa : VII          Lënda : Gjuhë shqipe</p> <p>Tema mësimore: Kulture tradicionale-Këngët e kreshnikëve</p>		
<p><b><u>Materiale dhe mjete mësimore</u></b>          Tabela e zezë, shkumësa me ngjyra, gjuha shqipe          7</p>		<b><u>Metoda dhe teknika mësimore.</u></b> Brainstorming Shpjegim+diskutim Teknika e pyetjeve
<p><b>Përdorimi i teknologjisë informative :</b></p>		
<p><b>Kontributi në kompetencat kryesore :</b></p>		
1	<b>Kompetenca komunikim dhe të shprehur -- Komunikues efektiv</b>	1,2,3,4,5,6,7,8
2	<b>Kompetenca të tē menduarit -- Mendimtar kreativ dhe kritik</b>	1,2,3,4,5,6,7,8
3	<b>Kompetenca të tē mësuarit për tē nxënë - Nxënës i suksesshëm</b>	1,2,3,4,5,6,7
4	<b>Kompetenca për jetë, punë dhe mijedis - Kontribues produktiv</b>	1,2,3,4,5,6,7,8
5	<b>Kompetenca personale - Individ i shëndoshë</b>	1,2,3,4,5,6,7,8,9,10
6	<b>Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm</b>	1,2,3,4,5,6,7,8
<p><b>Fjalët kyçë:</b> këngët e kreshnikëve, zanat e malit, fuqi mbinatyrore, joreale</p>		
<p><b><u>Rezultatet e të nxënëtit.</u></b></p> <p><b>Njohuri gjuhësore:</b> Aftësi komunikuese          -Drejtohen dhe shprehen në mënyrë adekuate nëpërmjet gjuhës së folur dhe të shkruar  <b>Shkathtësi :</b>Të zgjidhurit e problemeve          -Zhvillon imaginatën dhe kreativitetin  <b>Sjellje:</b> Merr pjesë në diskutim  <b>Qëndrime:</b> Vetëvlerësimi  <b>Vlera:</b> Respekton mendimin e të tjerve  <b>Shprehi:</b> Të lexuarit, Të shkruarit</p>		
<p><b><u>Kriteret e suksesit-Resultate</u></b></p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Lexon me ndjenjë e emocion fragmentin e dhënë.</li> <li>-Diskuton mbi problemet që trajtohen në këtë fragment.</li> <li>-Analizon figurën e zanave dhe atë të Mujit</li> </ul>		

•

## ZHVILLIMI I MËSIMIT

### E □ Brainstorming

- . Mësuesi shkruan në tabelë emrin Muji e Halili
- . Ai u drejtohet nxënësve: - Ç’ dini ju për këto figura? - Ç’ dini ju për legjendat? Nxënësit do të shprehin mendimet e tyre

### R □ Shpjegim + diskutim

Mësuesi shpjegon se në epikën legjendare përfshihen këngë që bëjnë fjalë për ngjarje e heroizma të individive. Në epikën legjendare shqiptare, cikli i "Këngëve kreshnike" është më i njohuri dhe më i rëndësishmi. Kryeheronjtë janë Muji e Halili, dy vëllezër trima. Tematika e këtyre këngëve është adventureske. Trimëria, fuqitë mbinatyrore, bashkëpunimi me figurat mitologjike shqiptare, si Zanat dhe Orët e malit, tradhtitë dhe dashuria e respekti ndërmjet vëllezërve janë temat mbizotëruese.

Udhëzohen nxënësit që të hapin librat e leximit dhe ta lexojnë fragmentin mbi Mujin dhe Zanat.

### R Teknika e pyetjeve

Cilat mendoni se janë arsyet që u takuan Muji me Zanat ?

A ka mundësi që kjo të ndodhë edhe në ditët e sotme?

A keni dëgjuar apo lexuar ndonjë këngë tjeter legjendare personazhet kryesore janë kaq të fortë? Si e arriti Muji këtë?

Pse e ndihmuani Zanat?

Vëreni me kujdes vargjet e këngës dhe thoni ç' gjuhë është përdorur në këto vargje?

Përshkrimet janë interesante dhe plot figura të krahasimit e me hiperbola, gjeni ato?

Cili është elementi fantastik në këtë legjendë?

### LIDHJA ME FUSHAT E TJERA:

### VLERËSIMI:

Vlerëson nxënësit bazuar në përgjigjet e tyre, aktivizimin dhe përqendrimin e tyre.

### DETYRË SHTËPIE :

Krijoni një mbyllje për këngën

### Fusha e kurrikulës- Gjuhë dhe komunikim

### Shkalla e Kurrikulës/3/Klasa : VII

### Lënda : Gjuhë shqipe

Tema mësimore: Figurat mitologjike

### Materiale dhe mjete mësimore

Teksti i nxënësit, përvuja të nxënësve, materiale të ndryshme në lidhje me Orët e Zanat

### Metoda dhe teknika mësimore.

Stuhi mendimesh, *bisedë dëgjim i drejtar, organizues grafik*

### Përdorimi i teknologjisë informative :

### Kontributi në kompetencat kryesore :

1	<b>Kompetenca komunikim dhe të shprehur -- Komunikues efektiv</b>	<b>1,2,3,4,5,6,7,8</b>
2	<b>Kompetenca të të menduarit -- Mendimtar kreativ dhe kritik</b>	<b>1,2,3,4,5,6,7,8</b>
3	<b>Kompetenca të të mësuarit për të nxënë- Nxënës i suksesshëm</b>	<b>1,2,3,4,5,6,7</b>
4	<b>Kompetenca për jetë, punë dhe mjedis - Kontribues produktiv</b>	<b>1,2,3,4,5,6,7,8</b>
5	<b>Kompetenca personale - Individ i shëndoshë</b>	<b>1,2,3,4,5,6,7,8,9,10</b>
6	<b>Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm</b>	<b>1,2,3,4,5,6,7,8</b>

Fjalët kyçë: gojëdhëna, mite, figura mitologjike, zana, ora, shtojzovalle, dragua, gjarpër, tekst joletrar

### Rezultatet e të nxënëtit.

**Njohuri gjuhësore:** Aftësi komunikuese

- Interpreton idenë, rrëfimin, gjuhën e figurshme në tekste, pasuron fjalorin

**Shkathësi:** Të zgjidhurit e problemeve.

-Gjykojnë në mënyrë kritike dhe janë kreativë.

**Sjellje:** Tregojne vetëbesimin për punë të pavarrur

**Qëndrime,Vlera:**

- Merr pjesë në diskutim
- Bashkëpunon
- Kërkon dhe jep ndihmë

**Shprehi :**

- Zhvillon forma të veçanta të shkrimit,

### Kriteret e suksesit-Rezultate

- përcakton domethënien e figurave popullore të orëve, zanave e të shtojzovalleve;
- dallon figurat mitike dhe gojëdhënat për to.
- bën dallimin mes tekstit letrar dhe joletrar.
- diskuton për motivet e gojëdhënavë që dëgjon.

## ZHVILLIMI I MËSIMIT

### **E Stuhi mendimesh**

Nxënësit risjellin në vëmendje njohuritë mbi orët, zanat dhe shtojzovallet, si pjesë e krijimtarisë popullore

### **R Dëgjim i drejtuar**

Nxënësit lexojnë me kujdes materialin fq.56 për orët, zanat, shtojzovallet, dragoin, gjarpërin. Pastaj mësuesi/ja u vë nxënësve të dëgjojnë fragmente nga përralla dhe gojëdhëna të ndryshme dhe nxënësve u kërkohet të mbajnë shënimë duke nxjerrë fjalët dhe shprehjet e reja që gjejnë

### **R Organizues grafik**

Pyetjet rreth gojëdhënavë ndërtohen nga mësuesi/ja

<b>LIDHJA ME FUSHAT E TJERA:</b> Histori, Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave	<b>VLERËSIMI:</b>
<b>DETYRË SHTËPI :</b> U jetep detyrë nxënësve që të gjejnë të dhëna për Shtjefën Gjeçovin dhe ndihmesën e tij në kulturën shqiptare	

Fusha e kurrikulës- Gjuhë dhe komunikim Shkalla e Kurrikulës/3/Klasa : VII Lënda : Gjuhë shqipe	Tema mësimore: E Bija e henes dhe e diellit-M.Kuteli
<b>Materiale dhe mjete mësimore</b> Teksti mësimor <i>Gjuha shqipe</i> 7, fjalorë, tekste të ndryshme	<b>Metoda dhe teknika mësimore.</b> <i>Diskutim, leksion, shqyrtimi kategorizues, punë e pavarur</i>
<b>Përdorimi i teknologjisë informative :</b>	
<b>Kontributi në kompetencat kryesore :</b>	
1 <b>Kompetenca komunikim dhe të shprehur -- Komunikues efektiv</b>	1,2,3,4,5,6,7,8
2 <b>Kompetenca të të menduarit -- Mendimtar kreativ dhe kritik</b>	1,2,3,4,5,6,7,8
3 <b>Kompetenca të të mësuarit për të nxënë - Nxënës i suksesshëm</b>	1,2,3,4,5,6,7
4 <b>Kompetenca për jetë, punë dhe mjesid - Kontribues produktiv</b>	1,2,3,4,5,6,7,8
5 <b>Kompetenca personale - Individ i shëndoshë</b>	1,2,3,4,5,6,7,8,9,10
6 <b>Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm</b>	1,2,3,4,5,6,7,8
<b>Fjalët kyçë:</b> metonimia, figurë stilistike	
<b>Rezultatet e të nxënëtit.</b> <b>Njohuri gjuhësore:</b> Aftësi komunikuese -Drejtohen dhe shprehen në mënyrë adekuate, nëpërmjet gjuhës së folur dhe të shkruar <b>Shkathësi :</b> Të zgjidhurit e problemeve -Gjykojnë në mënyrë kritike dhe janë kreativë <b>Sjellje:</b> Puna grupore, <b>Qëndrime :</b> Vetëvlerësimi <b>Vlera:</b> Puna grupore, Kreativiteti, Të menduarit kritik <b>Shprehi :</b> Të lexuarit, Të shkruarit <b>Kriteret e suksesit-Resultate</b> Nxënësi/ja: – lexon dhe dallon përrallën, si lloj letrar me karakter fantastik; – nxjerr temën dhe mesazhin e përrallës; – u përgjigjet pyetjeve rreth të kuptuarit të përrallës	

- përcakton elementet e strukturës së përrallës;
- ritregon bukur përrallën.

## **ZHVILLIMI I MËSIMIT**

### **E □ *Stuhi mendimesh***

Mësuesi/ja u drejton nxënësve pyetje rreth përrallave dhe lidhjeve që secili ka me to.

*C'dini për përrallat?  
A ju pëlqejnë dhe pse?  
Ç'lidhje keni me përrallat?  
Kush ju ka rrëfyer më shumë përralla?  
Ç'lloj përrallash ju pëlqejnë më shumë?  
Ç'mund të thoni në lidhje me fundin e tyre?  
Kush i ka krijuar përrallat?*

Pas përgjigjeve të nxënësve në lidhje me përrallën, u bëhet e ditur se do të njihen me një përrallë, të rrëfyer jo drejtpërdrejt nga populli, por nga Mitrush Kuteli, një mbledhës shumë i njojur i rrëfenjave shqiptare.

*Mitrush Kuteli* (emri i tij i vërtetë **Dhimitër Pasko**) ka lindur në Pogradec, më 13 shtator 1907 dhe ka vdekur në Tiranë më 4 maj 1967. Ka qenë shkrimtar, përkthyes, kritik dhe ekonomist. Shquhet për mënyrën e rrëfimit dhe përshtatjet e mrekullueshme.

Veprat e tij kryesore për fëmijë janë:

*Pylli i gështenjave* (1958)

*Xinxifilua* (1962)

*Tregime të moçme shqiptare* (1965)

### **R *Parashikim me terma paraprakë***

Mësuesi/ja shkruan në dërrasë të zezë fjälët kyç: *hënë, diell, bijë, djalë, nënë, kuçedër* dhe u kërkohet nxënësve të krijojnë një situatë fantastike, bazuar në to.

Pas situatave të sjella nga nxënësit, lexohet titulli i pjesës dhe nxënësit krahasojnë situatën e krijuar prej tyre me atë që sjell titulli.

Nxënësit lexojnë pjesë-pjesë tekstin dhe parashikojnë çfarë do të ndodhë më pas, duke argumentuar parashikimet e tyre. Kërkohet nga nxënësit t'i vënë nga një titull secilës pjesë që lexohet.

P.sh.: lexohet pjesa dhe **ndalesa e parë** mund të jetë te “...vetëm në mal të kuçedrës të gjuash”. Pyeten nxënësit nëse djali do të dëgjojë nënën apo vashën e zemrës. Për këtë u kërkohet të kujtojnë titullin e pjesës, dhe parashikimit të rolit që do të ketë ky

personazh në përrallë.

Titulli i pjesës mund të jetë: *Djali dhe mali i kuçedrës*.

**Ndalesa e dytë** mund të jetë “... *Bëhu gati!*” Titulli i kësaj pjese mund të jetë:

*Përballja e trimit me kuçedrën*.

Pyeten nxënësit se si vazhdon pjesa.

**Ndalesa e tretë** “... *Mirë, nëma besën dhe shko!*”. Titulli: *Marrëveshja e djalit me kuçedrën*.

**Ndalesa e katër** “... *Kaq shumë më do?*”. Titulli: *Trimi, nëna dhe vasha*.

Nxënësit vazhdojnë me imagjinatën e tyre të parashikojnë se si do të veprojë djali.

**Ndalesa e pestë** “... *u mundua të prapset*”. *Përballja me kuçedrën*.

Nxënësit bëjnë dhe një parashikim dhe vazhdojnë me leximin e pjesës deri në fund.

Titulli: *Besa dhe fundi i kuçedrës*.

Pas leximit të pjesës bëhen komente të shkurtra mbi parashikimet e nxënësve dhe mbi elementet fantastike dhe reale që zotërojnë në përrallë.

Kalohet në punën me fjalorin, që kryesisht e shpjegojnë nxënësit dhe mësuesi/ja ndërhyn për të svaruar gjërat që ata nuk u japid përgjigje.

### R Pyetje-përgjigje

a. Pika 1. Pyeten nxënësit se përfarë bën fjalë përralla (Tema dhe mesazhi),

ku dhe kur zhvillohen ngjarjet (në përrallë koha dhe vendi janë të papërcaktuara), cilat janë personazhet dhe cilat janë detajet kryesore që lidhen me to: porosia e nënës, e vashës, kushti i kuçedrës, veprimi i djalit, zbulimi i identitetit të vashës).

b. Nxënësit ndajnë pjesën sipas elementeve të strukturës; hyrje, zhvillim, mbyllje e ndalen në ritregimin e mbylljes (pika 2).

**LIDHJA ME FUSHAT E TJERA:**  
Letërsi, arte

**VLERËSIMI:**  
Mësuesi/ja vlerëson nxënësit: për lexim të rrjedhshëm e me emocion të përrallës; për nxjerjen e mesazhit kryesor dhe mesazheve dytësore; për dallimin e elementeve fantastike dhe reale në përrallë, si veçori kryesore të saj; për përcaktimin e elementeve të strukturës, për ritregimin e përrallës, për aftësinë sintetizuese në përcaktimin e titujve të pjesëve; për aftësitë e punës në grup dhe bashkëpunimin

**DETÝRË SHTËPIE :** Jepet detyra e librit dhe në orën e ardhshme nxënësit të flasin rreth përjetimeve që patën kur treguan përrallën

**Fusha e kurrikulës- Gjuhë dhe komunikim**

**Shkalla e Kurrikulës/3/Klasa : VII**

**Lënda : Gjuhë shqipe**

Tema mësimore: E bija e hënës dhe e diellit II																				
<b>Materiale dhe mjete mësimore</b> Leximi 7, materiale nga burime të ndryshme	<b>Metoda dhe teknika mësimore.</b> Diskutim - Analizë e tipareve semantike - Punë e pavarur																			
<b>Përdorimi i teknologjisë informative :</b>																				
<b>Kontributi në kompetencat kryesore :</b>																				
<table border="1"> <tr> <td>1</td><td><b>Kompetenca komunikim dhe të shprehur -- Komunikues efektiv</b></td><td>1,2,3,4,5,<b>6</b>,7,8</td></tr> <tr> <td>2</td><td><b>Kompetenca të të menduarit -- Mendimtar kreativ dhe kritik</b></td><td>1,2,3,4,5,6,7,8</td></tr> <tr> <td>3</td><td><b>Kompetenca të të mësuarit për të nxënë - Nxënës i suksesshëm</b></td><td>1,2,3,4,5,6,7</td></tr> <tr> <td>4</td><td><b>Kompetenca për jetë, punë dhe mjedis - Kontribues produktiv</b></td><td>1,2,3,4,5,6,7,8</td></tr> <tr> <td>5</td><td><b>Kompetenca personale - Individ i shëndoshë</b></td><td>1,2,3,4,5,6,7,8,9,10</td></tr> <tr> <td>6</td><td><b>Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm</b></td><td>1,2,3,4,5,6,7,8</td></tr> </table>			1	<b>Kompetenca komunikim dhe të shprehur -- Komunikues efektiv</b>	1,2,3,4,5, <b>6</b> ,7,8	2	<b>Kompetenca të të menduarit -- Mendimtar kreativ dhe kritik</b>	1,2,3,4,5,6,7,8	3	<b>Kompetenca të të mësuarit për të nxënë - Nxënës i suksesshëm</b>	1,2,3,4,5,6,7	4	<b>Kompetenca për jetë, punë dhe mjedis - Kontribues produktiv</b>	1,2,3,4,5,6,7,8	5	<b>Kompetenca personale - Individ i shëndoshë</b>	1,2,3,4,5,6,7,8,9,10	6	<b>Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm</b>	1,2,3,4,5,6,7,8
1	<b>Kompetenca komunikim dhe të shprehur -- Komunikues efektiv</b>	1,2,3,4,5, <b>6</b> ,7,8																		
2	<b>Kompetenca të të menduarit -- Mendimtar kreativ dhe kritik</b>	1,2,3,4,5,6,7,8																		
3	<b>Kompetenca të të mësuarit për të nxënë - Nxënës i suksesshëm</b>	1,2,3,4,5,6,7																		
4	<b>Kompetenca për jetë, punë dhe mjedis - Kontribues produktiv</b>	1,2,3,4,5,6,7,8																		
5	<b>Kompetenca personale - Individ i shëndoshë</b>	1,2,3,4,5,6,7,8,9,10																		
6	<b>Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm</b>	1,2,3,4,5,6,7,8																		
Fjalët kyçë: përrallë, personazhe, mesazh, cilësi, veprime, figura																				
<p><b>Rezultatet e të nxënët.</b></p> <p><b>Njohuri gjuhësore:</b> Aftësi komunikuese - Komunikon mirë</p> <p><b>Shkathësi :</b> Të zgjidhurit e problemeve - Gjykojnë në mënyrë kritike dhe janë kreativë</p> <p><b>Sjellje:</b> Tregojne vetëbesimin për punë të pavarur</p> <p><b>Qëndrime :</b> Vetëvlerësimi</p> <p><b>Vlera:</b> Përdorin argumentin dhe kreativitetin</p> <p><b>Shprehi :</b> Të lexuarit, Të shkruarit</p> <p><b>Kriteret e suksesit-Rezultate</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- nxjerr <b>mesazhin e përrallës</b> dhe diskuton rreth tij;</li> <li>- liston elementet karakteristike (klishtë) të përrallës;</li> <li>- diskuton për veprimet e personazheve në përrallë;</li> <li>- përcakton veçori dhe karakteristika të tyre;</li> <li>- veçon figurat letrare më të bukura në përrallë.</li> </ul>																				
<b>ZHVILLIMI I MËSIMIT</b>																				
E <input type="checkbox"/> <i>Diskutim, Analizë e tipareve semantike</i>																				

Nxënësit flasin dhe diskutojnë rreth përjetimeve, shtrojnë pyetjet që patën dhe problemeve që hasën gjatë tregimit të përrallës para të afërmve të tyre më të vegjël. Ata mund të diskutojnë edhe për pyetje që u ngre mësuesi/ja, si p.sh: *Çfarë ju pëlqeu më shumë nga kjo përrallë? Cili nga personazhet është më i dashuri për ju?* etj.

Mësimi fillon me përcaktimin e mesazhit të përrallës dhe diskutimit rreth tij. (Pika 4 në interpretimin e përrallës). Nxënësit punojnë me figurat më të bukura të përshkrimit të personazheve sidomos kuçedrës, vashës dhe djalit (pika 7).

Vazhdohet me analizën e cilësive të personazheve dhe plotësohet tabela e tipareve semantike.

Mund të ndiqet pika 9 (gjuha dhe stili) ose mund të punohet me tabelën e mëposhtme për simbolikën që mbartin personazhet. Nxënësve mund t'u drejtoshet pyetja në këtë formë; çfarë simbolizon secili prej personazheve? Plotësoni me +!

#### **R Punë e drejtuar**

Personazhet	E mira	E keqja	Besa	Lumturia	E bukura	Vdekja	Dashuria	Vetmia	Jeta
Djali		+	+				+		
Vasha									
Kuçedra									

U kërkohet nxënësve të vëzhgojnë tabelën e plotësuar dhe të nxjerrin veçoritë e kundërtatë të personazheve (në cilat tipare duket kjo), duke arritur në përfundimin se çfarë përfaqëson secila nga figurat (punohet pika 8).

Në lidhje me gjuhën dhe veçoritë e strukturës së përrallës punohet pika 10.

#### **R Rrjet i diskutimit**

Po .Pse?

Jo,Pse?

A do të kishte qenë më mirë sikur djali të mos shkonte të gjuante në malin e kulcedrës

#### **LIDHJA ME FUSHAT E TJERA:**

Edukimi për qytetari demokratike

#### **VLERËSIMI:**

Mësuesi/ja vlerëson nxënësit për formulimin e saktë të **mesazhit** të përrallës; për dallimin e karakteristikave të përrallës që e dallojnë atë nga llojet e tjera të tekstit rrëfimtar; për vlerësimin e **personazheve** të përrallës sipas cilësive të tyre; për dallimin e

	figurave letrare të përdoruara në përrallë; për pjesëmarrjen në diskutim dhe argumentimin e saktë të mendimeve të tij.
<b>DETÝRË SHTËPIE :</b> Nëse nuk përfundohet ushtrimi 10, punohet në shtëpi dhe parapërgatiten për projektin. U kërkohet nxënësve të sjellin një përrallë të treguar nga gjyshërit ose prindërit e tyre. Porositen nxënësit të gjejnë një përrallë dhe ta shkruajnë atë me 5-6 fjali	

<b>Fusha e kurrikulës- Gjuhë dhe komunikim</b> <b>Shkalla e Kurrikulës/3/Klasa VII</b> <b>Lënda : Gjuhë shqipe</b>																			
Tema mësimore: Bisedë letrare mbi legjendat dhe baladat shqiptare																			
<u><b>Materiale dhe mjete mësimore</b></u> Leximi 7, materiale nga interneti rrith legjendave shqiptare, "Tregime të moçme shqiptare", M. Kuteli	<u><b>Metoda dhe teknika mësimore.</b></u> diskutim, diagram Venit ose tabela e krahasimit të , tabela e koncepteve të personazhit, kllaster, ditarët e të nxënësit, analiza të ndryshme gjuhësore, shkrimi i një letre, shkrime të lira, shkrime esesh, karrige e nxehëtë, empatia, punë në grupe etj																		
<b>Përdorimi i teknologjisë informative :</b>																			
<b>Kontributi në kompetencat kryesore :</b>																			
<table border="1"> <tr> <td>1</td> <td><b>Kompetenca komunikim dhe të shprehur -- Komunikues efektiv</b></td> <td>1,2,3,4,5,<b>6,7,8</b></td> </tr> <tr> <td>2</td> <td><b>Kompetenca të të menduarit -- Mendimtar kreativ dhe kritik</b></td> <td>1,2,3,<b>4,5,6,7,8</b></td> </tr> <tr> <td>3</td> <td><b>Kompetenca të të mësuarit për të nxënë- Nxënës i suksesshëm</b></td> <td>1,2,3,4,5,6,7</td> </tr> <tr> <td>4</td> <td><b>Kompetenca për jetë, punë dhe mjedis - Kontribues produktiv</b></td> <td>1,2,3,<b>4,5,6,7,8</b></td> </tr> <tr> <td>5</td> <td><b>Kompetenca personale - Individ i shëndoshë</b></td> <td>1,2,3,4,5,6,7,<b>8,9,10</b></td> </tr> <tr> <td>6</td> <td><b>Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm</b></td> <td>1,2,3,4,<b>5,6,7,8</b></td> </tr> </table>	1	<b>Kompetenca komunikim dhe të shprehur -- Komunikues efektiv</b>	1,2,3,4,5, <b>6,7,8</b>	2	<b>Kompetenca të të menduarit -- Mendimtar kreativ dhe kritik</b>	1,2,3, <b>4,5,6,7,8</b>	3	<b>Kompetenca të të mësuarit për të nxënë- Nxënës i suksesshëm</b>	1,2,3,4,5,6,7	4	<b>Kompetenca për jetë, punë dhe mjedis - Kontribues produktiv</b>	1,2,3, <b>4,5,6,7,8</b>	5	<b>Kompetenca personale - Individ i shëndoshë</b>	1,2,3,4,5,6,7, <b>8,9,10</b>	6	<b>Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm</b>	1,2,3,4, <b>5,6,7,8</b>	
1	<b>Kompetenca komunikim dhe të shprehur -- Komunikues efektiv</b>	1,2,3,4,5, <b>6,7,8</b>																	
2	<b>Kompetenca të të menduarit -- Mendimtar kreativ dhe kritik</b>	1,2,3, <b>4,5,6,7,8</b>																	
3	<b>Kompetenca të të mësuarit për të nxënë- Nxënës i suksesshëm</b>	1,2,3,4,5,6,7																	
4	<b>Kompetenca për jetë, punë dhe mjedis - Kontribues produktiv</b>	1,2,3, <b>4,5,6,7,8</b>																	
5	<b>Kompetenca personale - Individ i shëndoshë</b>	1,2,3,4,5,6,7, <b>8,9,10</b>																	
6	<b>Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm</b>	1,2,3,4, <b>5,6,7,8</b>																	
<b>Fjalët kyçë:</b> libër, personazh, vend, pjesa më e bukur, figura stilistike																			
<b>Rezultatet e të nxënëtit.</b> <b>Njohuri gjuhësore:</b> Aftësi komunikuese - Komunikon mirë <b>Shkathësi :</b> Të zgjidhurit e problemeve -Gjykojnë në mënyrë kritike dhe janë kreativë <b>Sjellje:</b> Tregojne vetëbesimin për punë të pavavar <b>Qëndrime:</b> Vetëvlerësimi																			

**Vlera:** Përdorin imaginatën dhe kreativitetin

**Shprehi:** Të lexuarit, Të shkruarit

**Kriteret e suksesit-Resultate**

- tregon me fjalët e tij një nga legjendat shqiptare;
- ritregon dhe interpreton një nga legjendat shqiptare;
- diskuton mbi personazhet, motivet, idetë, vlerat e legjendave
- përmbledh shkurt ngjarjet e legjendave
- ndërton pyetje rreth legjendave për shokët
- u përgjigjet pyetjeve që lidhen me të kuptuarit dhe interpretimin e legjendave
- përshkruan personazhet
- krahason variante të ndryshme të legjendave
- analizon strukturën, gjuhën dhe stilin e legjendave

**ZHVILLIMI I MËSIMIT**

**E □ Brainstorming**

Punohet me materiale nga interneti ose me libra të tjera me legjenda shqiptare.

Ora I

Çdo nxënës përzgjedh një legjendë për ta rrëfyer dhe mund të bëhen vetëvlerësimë të nxënësve për mënyrën e rrëfimit.

Për një nga legjendat (ndarja e tyre bëhet më parë), nxënësit mund të punojmë me shkrim në hartën e tregimit, duke evidentuar elemente të subjektit, si: parashtrimi, pika e lidhjes, konflikti, pika kulmore, zgjidhja e konfliktit. Kjo mund të jetë si një përmbledhje e shkurtër. Ndërtohen pyetje, gjëza dhe enigma rreth librit, përgjigjet për të cilat nxënësit i kërkojnë nga njëri-tjetri.

Për të nxitur të menduarit kritik, për të bërë nxënësit më të térhequr me librin u sugerojmë që pyetjet rreth të kuptuarit dhe interpretimit të ndërtohen nga vetë ata. Çdo nxënës duhet ta lexojë të gjithë librin, pavarësisht se cilën legjendë punon me shkrim. Si rrjedhojë, në kuizet, gjëzat rreth legjendave mund të marrin pjesë të gjithë nxënësit.

Nxënësit përshkruajnë personazhet duke përdorur teknika të ndryshme. Këtë përshkrim nxënësit përzgjedhin që ta punojnë me një nga teknikat që u pëlqen, për shembull, me diagram Veni (nëse ka për të kahasuar) kllaster, me shkrim të lirë, me tabelën e koncepteve të personazheve.

Personazhet	Cilësi fizike	Cilësi morale	Ku duken	Mendime	Veprime	Gjykimi yt për të
-------------	---------------	---------------	----------	---------	---------	-------------------

Ora II

Nxënësit bëjnë analizën gjuhësore dhe stilistikore të legjendave.

Ndalet në përdorimet e figurshme të fjalës, te leksiku, fjalori me fjalët e reja, llojet e fjalive, raportet e përshkrimeve me dialogë.

Evidenton pjesët më të bukura nga libri duke argumentuar pse.

Komenton me ditarët e të nxënët pjesë dhe shprehje të spikatura nga libri, fragmente, personazhe etj.

Shkruan ese (tekste vlerësuese) rreth vlerave dhe motiveve të një legjende

Përmes ematisë ose karriges së nxehët, nxënësit vënëvet në rolin e personazhit ose

<p>gjykojnë se si do të silleshin në të njëjtat situate.</p> <p>-Një nga pikat më të rëndësishme të kësaj bisede është krahasimi i legjendave me variantet e tjera të saj, sidomos me variantin në poezi të saj.</p> <p>P.sh. Balada “Kostandini dhe Doruntina”. Krahasimi i saj mund të bëhet me variantin “Besa e Kostandinit” në prozë, që gjendet në internet.</p> <p>E njëta mënyrë ndiqet edhe me variantin në vargje të “Gjergj Elez Alisë”. Si vjen ky variant te “Tregimet e moçme shqiptare”. Bëhet krahasimi duke u mbështetur në të gjitha elementet e renditura më sipër.</p> <p>Për legjendën “Kthimi i Ymer Agës” shfrytëzohet varianti në vargje.</p>	
<b>LIDHJA ME FUSHAT E TJERA:</b>	<b>VLERËSIMI:</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave</li> <li>- të drejtat e njeriut</li> <li>- mjedisi</li> </ul> <p><b>DETÝRË SHTËPIE :</b></p>	

## Përshkrimi dhe analiza e pamjeve

### 2. Gjuha figurative dhe jofigurative

<b>Fusha e kurrikulës- Gjuhë dhe komunikim</b> <b>Shkalla e Kurrikulës/3/Klasa : VII</b> <b>Lënda : Gjuhë shqipe</b>	
Tema mësimore: Gjuha e figurshme dhe gjuha e drejtëpërdrejtë	
<u><b>Materiale dhe mjete mësimore</b></u> Leximi 7, <i>Fjalori i gjuhës shqipe</i> , njohuritë e nxënësve	<u><b>Metoda dhe teknika mësimore.</b></u> -Diskutim, leksion i avancuar, punë e pavarur, shkrim i lirë.
<b>Përdorimi i teknologjisë informative :</b>	
<b>Kontributi në kompetencat kryesore :</b>	
1	<b>Kompetenca komunikim dhe të shprehur -- Komunikues efektiv</b>
2	<b>Kompetenca të të menduarit -- Mendimtar kreativ dhe kritik</b>
3	<b>Kompetenca të të mësuarit për të nxënë- Nxënës i suksesshëm</b>
4	<b>Kompetenca për jetë, punë dhe mjedis - Kontribues produktiv</b>
5	<b>Kompetenca personale - Individ i shëndoshë</b>
6	<b>Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm</b>
<b>Fjalët kyçe:</b> Kuptimi I drejtpërdrejtë,kuptim I figurshëm,metaforë,symbol,krahasim,metonimi,sinegdotë,personifikim,hyperbole,aliteracion	

### **Rezultatet e të nxënít.**

**Njohuri gjuhësore:** Aftësi komunikuese

- Interpretion idenë, rrëfimin, gjuhën e figurshme në tekste, pasuron fjalorin

**Shkathësi :** Të zgjidhurit e problemeve

-Gjykojnë në mënyrë kritike dhe janë kreativë

**Sjellje:**

Tregojne vetëbesimin për punë të pavarur

**Qëndrime,Vlera:**

- Merr pjesë në diskutim
- Bashkëpunon
- Kërkon dhe jep ndihmë

**Shprehi :**

- Zhvillon forma të veçanta të shkrimit,

**Kriteret e suksesit-Rezultate**

- dallon kuptimin e drejtpërdrejtë dhe të figurshëm të fjalëve;
- dallon metaforën nga metoniminë;
- përdor kuptimet e figurshme në të folur e në të shkruar.

### **ZHVILLIMI I MËSIMIT**

#### **E □ Punë e drejtuar/diskutim**

Nxënësve u jepen shembujt e mëposhtëm, shënohen në tabelë:

- Ajo po mbytet në një det pikëllimi. (Metafora)
  - Ai është i shpejtë si plumbi. (Krahasimi)
  - Deti u përplas me zemërim në anije. (Personifikimi)
  - Ju kam thënë një milion herë që ta pastroni dhomën tuaj! (Hiperbola)
  - Ajo jetonte në zinxhirë. (Simboli - Zinxhirët janë simbol i shtypjes)
- Më pas nxënësve iu drejtohen pyetje:

- Çfarë është kuptimi I fjalive të shënuara?
- Fjalët: det pikëllimi, shpejt si plumbi, në zinxhirë a janë fjalë me kuptim të pare apo jo? Cili është kuptimi I pare I tyre dhe çfarë po shprehin në fjalit?

#### **R □ Lekcion i avancuar**

Nxënësve u kërkohet që të shohin me kujdes shembullin e shkëputur nga *Fjalori i gjuhës shqipe* dhe të dallojnë kuptimin e drejtpërdrejtë dhe të figurshëm të fjalës *kokë*

**Kok/ë,-a f. sh**

Pjesa e sipërme e trupit të njeriut që qëndron mbi qafën ose pjesa e sipërme e trupit të kafshëve, e rrumbullakët a e zgjatur, ku ndodhen truri, goja, sytë, veshët, hunda, flokët etj. *Me kokë të madhe (të vogël). Kokë njeriu. Kokë dashi (viçi, kali, majmuni, peshku, gjarpri).*

Njësi për të numëruar bagëtinë: *30 kokë bagëti*.

**fig.** Pjesë e trupit të njeriut si qendra e të menduarit. *Njeri me kokë, me mend*.

4. Pjesë e trupit si përfaqësuese e gjallesës, jetës së njeriut. *Jap kokën për atdheun*.

**Fig.** Udhëheqës, drejtues i një vendi. *Turmë pa kokë*.

Zhardhoku i një bime. *Kokë lakre*.

Fillimi i një vargu qeniesh a sendesh. *Koka e kolonës*.

**fig.** Thelbi i diçkaje. *Muhabet pa kokë*.

Më pas nxënësve u sqarohet nga mësuesi/ja:

Gjuha e drejtpërdrejtë është gjuha e cila i përdor fjalët në kuptimin e tyre të parë, në kuptimin e tyre të saktë. Kjo gjuhë është karakteristike për gjuhën e shkencën, gazetarin dhe përfusha të tjera të përdorimit të gjuhës, përvèç letërsisë dhe formave të tjera të arteve dhe fikcionit. Gjuha e drejtpërdrejtë nuk lejon kurrrfarë keqkuptimesh.

Gjuha e drejtpërdrejtë është të shkruarit me fjalë të sakta, pikërisht ashtu siç e kanë kuptimin ato fjalë. Për shembull, kur thuhet: "Jam shumë i uritur" është thënë diçka në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe me fjalët që e kanë pikërisht atë kuptim.

Mirëpo, në situata të tjera për të shprehur të njëjtën domethënien, mund të thuhet: "Do ta kisha ngrënë një lopë", që është gjuhë e figurshme, pasi ne nuk është menduar pikërisht e njëjtë gjë që është thënë, por është përdorur një figurë letrare për të treguar se sa shumëuri ka folësi.

Kur përdorim fjalë të figurshme që janë të zakonshme, nuk ka rrezik të mos kuptohemi me lehtësi, por nëse përdorim figura të pazakonshme që i kemi ndërtuar atypëraty, dëgjuesit apo bashkëbiseduesit tonë i duhet të përpinqet më shumë për të na kuptuar. Në raste të tillë gjithmonë ka hapësirë për interpretim. Gjuha e figurshme, siç e tregon edhe emërtimi, mbështet në fjalë me kuptime të figurshme në vend se në fjalë me kuptim të parë dhe të saktë.

#### R□*Punë e pavarur/shkrim i lirë*

Fragmentin nga "Vdekja më vjen prej syve të tillë", zhvishe nga gjuha e figurshme dhe shkruaje sikur të kishte qenë deklaratë e një personi!

#### LIDHJA ME FUSHAT E TJERA:

Edukimi për qytetari demokratike

#### VLERËSIMI:

Vlerësimi i nxënësve bëhet duke u mbështetur në aftësitë e tyre për të dalluar dhe përdorur fjalët me kuptim të drejtpërdrejtë dhe të figurshëm

#### DETÝRË SHTËPIE :

Ushtrimi 1. Gjej një tekst gazete, një shkrim për një ndeshje futbolli ose një shkrim për ndonjë këngëtar të njohur dhe përpiku ta ndryshosh tekstin duke përdorur gjuhë të figurshme

#### Figurat stilistike:

##### Fusha e kurrikulës- Gjuhë dhe komunikim

##### Shkalla e Kurrikulës/3/Klasa : VII

##### Lënda : Gjuhë shqipe

Tema mësimore: Figurat stilistike

##### Materiale dhe mjete mësimore

Gjuha shqipe 7, fragmente poezish nga libra të ndryshëm për analizë.

##### Metoda dhe teknika mësimore.

*Stuhi mendimi, recitim, punë e pavarur, punë e drejtar, analizë shembujsh, diskutim, ditarët e të nxënës*

#### Përdorimi i teknologjisë informative :

**Kontributi në kompetencat kryesore :**

1	<b>Kompetenca komunikim dhe të shprehur -- Komunikues efektiv</b>	<b>1,2,3,4,5,6,7,8</b>
2	<b>Kompetenca të të menduarit -- Mendimtar kreativ dhe kritik</b>	<b>1,2,3,4,5,6,7,8</b>
3	<b>Kompetenca të të mësuarit për të nxënë- Nxënës i suksesshëm</b>	<b>1,2,3,4,5,6,7</b>
4	<b>Kompetenca për jetë, punë dhe mjedis - Kontribues produktiv</b>	<b>1,2,3,4,5,6,7,8</b>
5	<b>Kompetenca personale - Individ i shëndoshë</b>	<b>1,2,3,4,5,6,7,8,9,10</b>
6	<b>Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm</b>	<b>1,2,3,4,5,6,7,8</b>

Fjalët kyçë: figurë stilistike, hiperbole, krahasim, epitet, metaforë

**Rezultatet e të nxënëtit.**

**Njohuri gjuhësore:** Aftësi komunikuese

- Interpreton idenë, rrëfimin, gjuhën e figurashme në tekste, pasuron fjalorin

**Shkathësi :** Të zgjidhurit e problemeve

-Gjykojnë në mënyrë kritike dhe janë kreativë

**Sjellje:**

Tregojne vetëbesimin për punë të pavarur

**Qëndrime,Vlera:**

- Merr pjesë në diskutim
- Bashkëpunon
- Kërkon dhe jep ndihmë

**Shprehi :**

- Zhvillon formën të veçanta të shkrimit,

**Kriteret e suksesit-Resultate**

- Liston figurat kryesore letrare
- Dallon figurat kryesore letrare
- Shpjegon efektin stilistik të figurave në shembujt e dhënë.

**ZHVILLIMI I MËSIMIT**

**E □ Brainstorming-recitim**

U kërkojmë nxënësve të recitojnë vargje nga një poezi që atyre u pëlqen dhe u ka mbetur në kujtesë.

Nxënësit japidnë vetë një koment të shkurtër rreth asaj që i pëlqen në këtë poezi.

Gjatë diskutimit duhet të dalë në pah veçoritë e poezisë:

zakonisht shprehen mendime e ndjesi të poetit,

shkruhet në vargje,

dallohet për figuracionin e pasur (për figurat letrare).

Nxënësit vetë mund të japid vetë përkufizimin e figurave letrare, që njohin nga vitet e kaluara, si një përdorim i fjalës, jo në kuptim të drejtpërdrejtë, por në mënyrë figurative, që transmeton më me emocion ndjenja, mendime, dhe vlera estetike e artistike.

**R □ Lexim i drejtuar, analizë shembujsh**

Nxënësit lexojnë tekstin fq49. Pastaj zgjidhin detyrën 3 nga Fletore pune, fq.63

**R □ Diskutim**

Zgjidhet diskutohen me klasën

**LIDHJA ME FUSHAT E TJERA:**

**VLERËSIMI:**

Bëhet vlerësimi i nxënësve për aktivizimin gjatë orës së mësimit, për saktësinë dhe argumentimin e përgjigjeve

**DETÝRË SHTËPIE :**

Fletore pune, ushtrimi 4, fq.64

Fusha e kurrikulës- Gjuhë dhe komunikim

Shkalla e Kurrikulës/3/Klaza : VII

Lënda : Gjuhë shqipe

Tema mësimore: Krahasimi

**Materiale dhe mjete mësimore**

Teksti mësimor *Gjuha shqipe 7*, fjalorë, tekste të ndryshme

**Metoda dhe teknika mësimore.**

*Diskutim, DLTA, shqyrtimi kategorizues, punë e pavarur dhe diskutim.*

**Përdorimi i teknologjisë informative :**

**Kontributi në kompetencat kryesore :**

1	<b>Kompetenca komunikim dhe të shprehur -- Komunikues efektiv</b>	1,2,3,4,5,6,7,8
2	<b>Kompetenca të të menduarit -- Mendimtar kreativ dhe kritik</b>	1,2,3,4,5,6,7,8
3	<b>Kompetenca të të mësuarit për të nxënë - Nxënës i suksesshëm</b>	1,2,3,4,5,6,7
4	<b>Kompetenca për jetë, punë dhe mjesid - Kontribues produktiv</b>	1,2,3,4,5,6,7,8
5	<b>Kompetenca personale - Individ i shëndoshë</b>	1,2,3,4,5,6,7,8,9,10
6	<b>Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm</b>	1,2,3,4,5,6,7,8

**Fjalët kyçë:** Krahasim, figurë stilistike

**Rezultatet e të nxënët.**

**Njohuri gjuhësore:** Aftësi komunikuese

-Drejtohen dhe shprehen në mënyrë adekuate nëpërmjet gjuhës së folur dhe të shkruar

**Shkathtesi :** Të zgjidhurit e problemeve

-Gjykojnë në mënyrë kritike dhe janë kreativë

**Sjellje:**

Puna grupore,

**Qëndrime :**

Vetëvlerësimi

**Vlera:**

Puna grupore, Kreativiteti, Të menduarit kritik

**Shprehi :**

Të lexuarit, Të shkruarit

**Kriteret e suksesit-Rezultate**

Nxënësi/ja:

- njeh krahasimin si figurë stilistike
- analizon kuptimin e krahasimit si figurë stilistike në tekston
- kpton rëndësinë e përdorimit të figurave stilistike
- përdor krahasimin gjatë komunikimit

**ZHVILLIMI I MËSIMIT****E □ Diskutim**

Mësuesi/ja organizon mësimin me pyetje nga mësimi i kaluar, përfshirë të nxitur diskutimin në klasë, duke pyetur:

- *C'janë figurat stilistike?*
- *Cilat figura stilistike i kemi mësuar deri tani?*
- *Ilustroni me shembuj!*

**R □ DLTA/Shqyrtimi kategorizues**

Mësuesi/ja fillon mësimin duke prezantuar pjesën e tekstit, që do të dëgjohet "Gjuha shqipe" - Çajupi në youtube  
<https://www.youtube.com/watch?v=mDIXyDm14D4>

Mësuesi/ja kërkon që nxënësit të mbajnë shënim përsa më shumë simbole (simboli ndërtohet kur një fjalë ka kuptimin e vet, por përdoret përfshirësisht të ndryshme) që dëgjojnë.

Nëpërmjet teknikës së shqyrtimit kategorizues, mësuesi/ja do të synojë shqyrtimin e fjalëve të zgjedhura nga nxënësit, duke realizuar një analizë kuptimore të tyre. Mësuesi/ja i kërkon nxënësve të shkruajnë në një tabelë, veçoritë kuptimore që kanë fjalët e zgjedhura. P.sh.: Punëtore si bleta; Trim si luani; I shpejtë si plumbi.

Kështu veprohet përfshirësisht që kanë zgjedhur nxënësit. e përqendrojmë vëmendjen e nxënësve në përdorimin e krahasimit.

Mësuesi/ja vijon shpjegimin përfshirësisht krahasimin

Krahasimi është një figurë letrare me ç'rast përdoren lidhëzat krahasuese "si" ose "sa" përfshirësisht krahasuar një objekt ose koncept me një tjetër, përfshirësisht sugjeruar se janë njësoj

**R□Punë e pavarur**

Nxënësit punojnë në mënyrë përfshirësisht ushtrimet në Fletore pune, fq.64.

<b>LIDHJA ME FUSHAT E TJERA:</b> Letërsi, arte
---

<b>VLERËSIMI:</b> Vlerësim i vazhdueshëm
---

**DETÝRË SHTËPIE :**  
**punë e diferencuar**

<p>Fusha e kurrikulës- Gjuhë dhe komunikim Shkalla e Kurrikulës/3/Klasa: VII Lënda: Gjuhë shqipe</p> <p>Tema mësimore: Simboli</p>	
<b>Materiale dhe mjete mësimore</b> Teksti mësimor <i>Gjuha shqipe 7</i> , fjalorë, tekste të ndryshme	<b>Metoda dhe teknika mësimore.</b> <i>Diskutim, DLTA, shqyrtimi kategorizues, punë e pavarur dhe diskutim.</i>
<b>Përdorimi i teknologjisë informative :</b>	
<b>Kontributi në kompetencat kryesore :</b>	
1	<b>Kompetenca komunikim dhe të shprehur -- Komunikues efektiv</b>
2	<b>Kompetenca të të menduarit -- Mendimtar kreativ dhe kritik</b>
3	<b>Kompetenca të të mësuarit për të nxënë- Nxënës i suksesshëm</b>
4	<b>Kompetenca për jetë, punë dhe mjesid - Kontribues produktiv</b>
5	<b>Kompetenca personale - Individ i shëndoshë</b>
6	<b>Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm</b>
<b>Fjalët kyçe:</b> Simbol, figurë stilistike,	
<p><b>Rezultatet e të nxënëtit.</b></p> <p><b>Njohuri gjuhësore:</b> Aftësi komunikuese -Drejtohen dhe shprehen në mënyrë adekuate nëpërmjet gjuhës së folur dhe të shkruar</p> <p><b>Shkathtesi :</b>Të zgjidhurit e problemeve -Gjykojnë në mënyrë kritike dhe janë kreativë</p> <p><b>Sjellje:</b> Puna grupore, <b>Qëndrime :</b> Vetëvlerësimi</p> <p><b>Vlera:</b> Puna grupore, Kreativiteti, Të menduarit kritik</p> <p><b>Shprehi :</b> Të lexuarit, Të shkruarit</p> <p><b>Kriteret e suksesit-Rezultate</b></p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- njeh simbolin si figurë stilistike</li> <li>- analizon kuptimin e simbolit në tekston</li> <li>- kupon rëndësinë e përdorimit të figurave stilistike</li> </ul>	

## ZHVILLIMI I MËSIMIT

### E □ Diskutim

Mësuesi/ja organizon mësimin me pyetje nga mësimi i kaluar, për të nxitur diskutimin në klasë, duke pyetur:

- *C'janë figurat stilistike?*
- *Si klasifikohen ata?*
- *Ilustroni me shembuj*

### R □ DLTA/Shqyrtimi kategorizues

Mësuesi/ja fillon mësimin duke prezantuar pjesën e tekstit, që do të lexohet dhe zgjedh njërin nga nxënësit për të bërë të mundur leximin e pjesës së zgjedhur në krye të mësimit. Leximi bëhet i shtruar, me qëllim që nxënësit të kenë mundësi të shkruajnë në fletore sa më shumë fjalë që i fiksohen. Mësuesi/ja kërkon që nxënësit të mbajnë shënim për sa më shumë simbole(simboli ndërtohet kur një fjalë ka kuptimin e vet, por përdoret për të përfaqësuar diçka krejtësisht të ndryshme) që dëgjojnë.

Nëpërmjet teknikës së shqyrtimit kategorizues, mësuesi/ja do të synojë shqyrtimin e fjalëve të zgjedhura nga nxënësit, duke realizuar një analizë kuptimore të tyre. Mësuesi/ja i kërkon nxënësve të shkruajnë në një tabelë, veçoritë kuptimore që kanë fjalët e zgjedhura. P.sh.: -Ajo ende jeton në zinxhirë. (fjala zinxhir ka kuptimin e robërisë)

Kështu veprohet për të gjithë fjalët që kanë zgjedhur nxënësit. e përqendrojmë vëmendjen e nxënësve në përdorimin e simbolit.

Mësuesi/ja vijon shpjegimin për simbolin

Figura e simbolit ndërtohet kur një fjalë ka kuptimin e vet, por përdoret për të përfaqësuar diçka krejtësisht të ndryshme:

- E gjithë bota është një skenë dhe të gjithë burrat dhe gratë janë thjesht lojtarë.
- Ata kanë daljet dhe hyrjet e tyre dhe një njeri në kohën e tij luan shumë pjesë;etj.

### R □ Punë e pavarur

Nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur ushtrimet në Fletore pune,fq.62-63

<b>LIDHJA ME FUSHAT E TJERA:</b> Letërsi,arte	<b>VLERËSIMI:</b> Vlerësim i vazdueshëm
<b>DETYRË SHTËPIE:</b> Punë e diferencuar	

Fusha e kurrikulës- Gjuhë dhe komunikim Shkalla e Kurrikulës/3/Klasa : VII Lënda: Gjuhë shqipe Tema mësimore: Metafora	<b>Materiale dhe mijte mësimore</b> Teksti mësimor <i>Gjuha shqipe 7</i> , fjalorë,tekste të ndryshme	<b>Metoda dhe teknika mësimore.</b> <i>Diskutim, leksion, shqyrtim kategorizues, punë e pavarur</i>
---	--	--

<b>Përdorimi i teknologjisë informative:</b>		
<b>Kontributi në kompetencat kryesore:</b>		
1	<b>Kompetenca komunikim dhe të shprehur -- Komunikues efektiv</b>	1,2,3,4,5,6,7,8
2	<b>Kompetenca të të menduarit -- Mendimtar kreativ dhe kritik</b>	1,2,3,4,5,6,7,8
3	<b>Kompetenca të të mësuarit për të nxënë- Nxënës i suksesshëm</b>	1,2,3,4,5,6,7
4	<b>Kompetenca për jetë, punë dhe mjedis - Kontribues produktiv</b>	1,2,3,4,5,6,7,8
5	<b>Kompetenca personale - Individ i shëndoshë</b>	1,2,3,4,5,6,7,8,9,10
6	<b>Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm</b>	1,2,3,4,5,6,7,8
<b>Fjalët kyçë:</b> metaforë, figurë stilistike,		
<p><b>Rezultatet e të nxënëtit.</b></p> <p><b>Njohuri gjuhësore:</b> Aftësi komunikuese -Drejtohen dhe shprehen në mënyrë adekuate nëpërmjet gjuhës së folur dhe të shkruar.</p> <p><b>Shkathtësi :</b>Të zgjidhurit e problemeve -Gjykojnë në mënyrë kritike dhe janë kreativë</p> <p><b>Sjellje:</b> Puna grupore,</p> <p><b>Qëndrime :</b> Vetëvlerësimi</p> <p><b>Vlera:</b> Puna grupore, Kreativiteti, Të menduarit kritik</p> <p><b>Shprehi :</b> Të lexuarit, Të shkruarit</p> <p><b>Kriteret e suksesit-Rezultate</b></p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- njeh metaforen si figurë stilistike</li> <li>- analizon kuptimin e metaforës si figurë stilistike në tekston</li> <li>- kupton rëndësinë e përdorimit të figurave stilistike</li> <li>- përdor metaforë gjatë komunikimit</li> </ul>		
<b>ZHVILLIMI I MËSIMIT</b>		
<p><b>E <input type="checkbox"/> Diskutim</b></p> <p>Mësuesi/ja organizon mësimin me pyetje nga për të nxitur diskutimin në klasë, duke pyetur:</p> <p>Ç;kuptoni me shprehjet :</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-E lexova Naimin</li> <li>- Hëngra dy pjata</li> <li>-I ka hyrë lepuri në bark etj</li> </ul> <p><b>R <input type="checkbox"/> Leksion/Shqyrtimi kategorizues</b></p>		

Mësuesi/ja fillon mësimin duke prezantuar pjesën e tekstit,

Metafora (gr. meta – përtej, phero – mbaj që andej: metaphore – bartje, transferim) – është një nga figurat kryesore poetike. Nga këndej është një trop shumë i rëndësishëm dhe përmendet më së shpeshti në analizën e teksteve poetike. Roli i saj është shumë i madh në pasurimin e gjuhës, sepse me anë të metaforave fjalët marrin kuptime dhe nuanca të reja. Kjo figurë, në të vërtetë, është bërë tipar kryesor i poezisë moderne. Ajo e nxit lexuesin të mendojë për atë se ç’do të thotë dhe ç’tregohet me të, pra e nxit lexuesin të zbulojë kuptimin e saj. Veçoria themelore e saj qëndron në kalimin e zakonshëm të një fjale a togfjalësh përdoret në lidhje të re me kuptim të figurshëm në bazë të ngjashmërisë. Kjo do të thotë se metafora është një fjalë e figurshme me të cilën emërtojmë një send me një fjalë tjetër, që i ngjan asaj. Shumë teoricienë e përcaktojnë metaforën si krahasim të shkurtuar ose si krahasim, ku shprehet krahu i dytë i krahasimit. Kështu, në vend që të thuhet: Ai është frikacak si lepuri, thuhet Ai është lepur. Pra, këtu është hequr lidhësja si, duke rënë kështu një nga elemntet e krahasimit, por megjithatë krahasimi ndjehet vetveti. Ose në shembullin: Në mesin tonë s’ka lepur, humb krahasimi dhe se me fjalën lepur mendohet për njerëzit me karakter të dobët. Me anë të metaforës autori dëshiron t’i theksojë tiparet e ngjashmërisë ose ndryshimet e sendeve apo të fenomeneve. Për shembull në vargjet:

Molla t’kuputna nji deget  
dy qershija lidhë n’ji rrfanë,  
ku fillojnë kufijt e Geget;  
rrijnë dy çika me nji nanë.  
(Ndre Mjeda, Andrra e jetës)

Ndre Mjeda, në vend që të thotë se vajzat ishin të bukura dhe e donin njëra-tjetren, përdor fjalët molla dhe dy qershija.

Sendet ose fenomenete ndryshme të jetës mund t’i përngajnë njëri –tjetrit me anë të veprimeve ose me anë të cilësive, ose pamjes së tyre. Metafora mund të jetë disa llojesh. Ajo mund të jetë metaforë e ndërtuar me emra, mbiemra dhe folje, p.sh.qafë mali, buzë deti, grykë mali, këmbët e tryezës, kryet e vendit, kryet e punës, anija e shkrëtëtirës, pranvera e jetës (në këta shembuj është bërë përgjasimi i pjesëve të sendeve të pajetë me pjesët e organizmit të gjallë); lind dielli, bleron pylli, valon deti, era fryn, shpërthyen trëndafilat, u veshën lisat, natyra qesh, qielli vrahet (në këta shembuj përgjasimi është bërë përmes veprimit të foljeve); vullnet të fortë, vullnet të çeliktë, zemër të butë, tabllo e gjallë, rrethanë e trishtuar(përgjasimi i cilësisë së një objekti është trguar me anë të mbiemrave, të cilët tregojnë cilësinë e mendjes, të ndjenjave dhe të gjendjes shpirtërore të njeriut). Metaforën e ndeshim edhe në proverbat popullore: Gardhi ka sy e muri vesh; Dardha e ka bishtin mbrapa; Trimi i mirë me shokë shumë; I hodhi hi syve; I ra në qafë etj.

Metaforat e krijuara nga populli i përdorin edhe shkrimtarët në veprat e tyre, por ata krijojnë edhe vetë metafora. Andaj në letërsinë artistike ndeshim në shumë shprehje metaforike.

Vendi dridhej, ay mbeti  
Se s’tronditej nga tërmeti  
Trim tribun ‘i vegjëlisë  
Dif-Dragoj i Dragobisë.  
  
O bajram, bajrak i gjallë  
More nam me gjak në ballë  
Te një shpellë e Dragobisë  
Yll i rrallë i burrërisë.  
  
Than’u shtri e than’u vra  
Po ti s’vdiqe, or Baba  
As te shkëmb’i Dragobisë  
As te zemër’e Djalërisë.

As je vrarë e as po vritesh,  
Legjendar Ante po rritesh  
Dithiramb i Dragobisë,  
Tmerr, panik i mizorisë.  
(Fan Noli, Shpell'e Dragobisë)

Një lloj metafore kemi kur shpirtëzohen sendet a dukuritë, dmth. kur nga një frysor kalohet te një jofrysor, p.sh. një metaforë të tällë e ndeshim te vjersha Mërgim të Lasgush Poradecit:

U nis burimi zemërak  
Prej shkëmbit të ronitur,  
Dhe shkoj i pastër si zëmbak  
E dyke pëshpëritur.

Ahere jargavan'i ri  
Q'e pa me shpirt të gjorë,  
Një degë t'ulur sipër ti  
J-a s gjati si një dorë...

Ahere dega që vështroj  
Ndaj shkëmbeve si thyet,  
E drodhi lulen e rënkoj  
Dhe j-a veniti kryet...

Dh'ahere luleja q'u tund,  
E ndoqi larg së koti,  
Pa që prej degës mun në fund,  
Pikoj si pikë loti...-

Ish dora që më përqafon,  
Ish kryet e anuar,  
Ish lot'i Vashës që pikon  
Pas Trimit që pat shkuar.

(Lasgush Poradeci, Trimi, Poezi, Prishtinë, 1968, f.132)

Lloj tjetër të metaforës kemi kur kalohet nga një frysor te një frysor tjetër. Llojin e këtillë të metaforës e ndeshim sidomos në fabula, kur kafshët flasin, mendojnë etj. si njerëzit ose anasjelltas, kur njerëzit bëjnë si zogjtë, si kafshët, marrin vetitë e tyre. Këtë lloj metafore e ndeshim në vjershën Shko dallëndyshë të Filip Shirokës.

Lloj tjetër të metaforës kemi kur nga një jofrysor kalohet te një frysor, dmth. kur bëhet sendëzimi i së gjallës ose i vettive psikologjike. (Ai ishte në gjendje të rëndë shëndetësore – ku fjala të rëndë përgjason me peshën fizike të njeriut dhe lidhet me gjendjen shpirtërore të tij). Metonimia (gr. metonimia – meta = pas, përtej dhe onoma – emër, ndërrim, zëvendësim emrash) – është një trop i cili tregon një objekt me anë të një objekti tjetër në bazë të afersisë dhe jo të ngjashmërisë siç ndodh me metaforën, dmth. metonimia krijohet kur një nocion (objekt) shprehet me një nocion tjetër, i cili ndodhet në lidhje logjike me të parin ose është simbol material i tij, në vend që të merret shprehja e rëndomtë, adekuate: Ai ka flokët e thinjura, ku shprehja flokët e thinjura nuk paraqet vetëm sendin ose dukurinë me të cilën ka të bëjë, por me të kuptohet koncepti i pleqërisë me të cilin është në lidhje logjike (me kuptimin e parë). Kjo do të thotë se në vend të emrit të natyrshëm, përdoret një fjalë tjetër, që ka lidhje të ngushtë me të. Shembuj të metonimisë kemi në këto shprehje: Marsi (perëndi e luftës) themi për luftën; dimri përtë ftohtit; djersën për mundin etj. Lidhjet midis këtyre sendeve, Marsit dhe luftës, dimrit dhe të ftohtit, djersës dhemundit, kanë raport varësie, sepse të ftohtit varet nga dimri, është efekt i dimrit, djersa është efekt i mundit, i lodhjes.

Meqë raportet midis varësisë së objekteve janë të shumëllojshme, si pasojë e kësaj edhe shumë lloje metonimish.

Ndër llojet më kryesore të metonimisë numërohen:  
-kur përdorim shkakun për pasojën (efektin): Dimri prishi pemët (në vend të themi të ftohtit,

si shkak i dimrit, kurse tē ftohtit éshtë si pasojë (efekt) e dimrit (dimri – shkak i tē ftohtit – që éshtë efekt i tij).

-kur përdorim pasojën (efektin) në vend tē shkakut; E fitova bukën me djersën e ballit në vend tē E fitova bukën e gojës me punë ku djersa – pasojë, efekt i mundit, kurse puna – shkak i djersës.

-kur nē vend tē veprës përdorim autorin: Lexova Naimin, Shekspirin, nē vend tē Lexova veprat e Naimit, Shekspirit etj.

-kur përdorim gjënë abstrakte nē vendt tē gjësë konkrete: Virtytin tē gjith e duan, kurse vesin e përbuzin (dmth.njeriu e virtytshëm e lëvdojnë tē gjithë, kurse njeriu me ves e urrejnë).

-kur konkreten e përdorim nē vend tē abstraktes: I ka hyrë lepuri nē bark (I ka hyrë frika nē bark).

-vendin a sendin që përmban diçka nē vend tē asaj që ndodhet nē tē: hëngra dy pjata; piva një filxhan.

Nëpërmjet teknikës së shqyrtimit kategorizues, mësuesi/ja do tē synojë shqyrtimin e fjalëve tē zgjedhura nga nxënësit, duke realizuar një analizë kuptimore tē tyre. Mësuesi/ja i kërkon nxënësve tē shkruajnë nē një tabelë, veçoritë kuptimore që kanë fjalët e zgjedhura. P.sh.: Punëtore si bleta; Trim si luani; I shpejtë si plumbi.

Kështu veprohet pér tē gjithë fjalët që kanë zgjedhur nxënësit. e përqendrojmë vëmendjen e nxënësve nē përdorimin e kahasimit.

#### R□*Punë e pavarur*

Nxënësit punojnë nē mënyrë tē pavarur ushtrimet nē Fletore pune, fq.64

<b>LIDHJA ME FUSHAT E TJERA:</b> Letërsi, arte	<b>VLERËSIMI:</b> Vlerësim i vazhdueshëm
<b>DETYRË SHTËPIE: punë e diferencuar</b>	

Fusha e kurrikulës- Gjuhë dhe komunikim Shkalla e Kurrikulës/3/Klasi : VII Lënda : Gjuhë shqipe Tema mësimore: Personifikimi	
<b>Materiale dhe mjete mësimore</b> Teksti mësimor <i>Gjuha shqipe</i> 7, fjalorë, tekste tē ndryshme	<b>Metoda dhe teknika mësimore.</b> <i>Diskutim, leksion, shqyrtimi kategorizues, punë e pavarur</i>
<b>Përdorimi i teknologjisë informative :</b>	
<b>Kontributi nē kompetencat kryesore :</b>	
1   <b>Kompetenca komunikim dhe tē shprehur -- Komunikues efektiv</b>	1,2,3,4,5,6,7,8
2   <b>Kompetenca tē tē menduarit -- Mendimtar kreativ dhe kritik</b>	1,2,3,4,5,6,7,8
3   <b>Kompetenca tē tē mësuarit pér tē nxënë- Nxënës i suksesshëm</b>	1,2,3,4,5,6,7

4	<b>Kompetenca për jetë, punë dhe mjedis - Kontribues produktiv</b>	1,2,3,4,5,6,7,8
5	<b>Kompetenca personale - Individ i shëndoshë</b>	1,2,3,4,5,6,7,8,9,10
6	<b>Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm</b>	1,2,3,4,5,6,7,8
<b>Fjalët kyçë:</b> simboli, figurë stilistike,		
<p><b>Rezultatet e të nxënëtit.</b></p> <p><b>Njohuri gjuhësore:</b> Aftësi komunikuese -Drejtohen dhe shprehen në mënyrë adekuate nëpërmjet gjuhës së folur dhe të shkruar</p> <p><b>Shkathtësi :</b>Të zgjidhurit e problemeve -Gjykojnë në mënyrë kritike dhe janë kreativë</p> <p><b>Sjellje:</b> Puna grupore,</p> <p><b>Qëndrime :</b> Vetëvlerësimi</p> <p><b>Vlera:</b> Puna grupore, Kreativiteti, Të menduarit kritik</p> <p><b>Shprehi :</b> Të lexuarit, Të shkruarit</p> <p><b>Kriteret e suksesit-Rezultate</b></p> <p>Nxënësi/ja:            - njeh metaforen si figurë stilistike            - analizon kuptimin e metaforës si figurë stilistike në tekston            - kupton rëndësinë e përdorimit të figurave stilistike            - përdor metaforë gjatë komunikimit</p>		
<b>ZHVILLIMI I MËSIMIT</b>		
<p><b>E □ Diskutim</b></p> <p>Mësuesi/ja organizon mësimin me pyetje për figurat stilistike të mësuara nga orët e kaluara</p> <p><b>R □ Lekcion/Shqyrimi kategorizues</b></p> <p>Mësuesi/ja fillon mësimin duke prezantuar pjesën e tekstit,</p> <p>Personifikimi (lat. persona – personi, facare dhe facere – bëj, punoj) është një nga figurat më të vjetra, në mos më e vjetra dhe më e përdorura në folklor. Përmes kësaj figure artistike, gjërave, sendeve abstrakte, kafshëve e bimëve u jepen cilësi njerëzish. Dmth. me anë të personifikimit shpirtëzohen gjérat e pashpirtë, sendet e pajetë, duke i bërë ao të mendojnë, të veprojnë e të kuptojnë si njerëz. Në entuziazmin dhe në përfjetimin e tij të natyrës njeriu mendon se edhe sendet ndjejnë, se edhe ato kanë shpirt dhe kështu i personifikon duke treguar veçori të cilat u përkasin njerëzve. Personifikime mjaft të goditura gjejmë si në folklor, ashtu edhe në letërsinë artistike.</p> <p>Tridhjet e nëntë mos ardhët kurrë që na rrëzove flamurë! “Ç’ke, oflamur, që s’valon?</p>		

“Jam sëmurë, po rënkoj,  
jam goditur bri’më brinjë,  
që kur sollën Italinë.  
(Këngë popullore)

Në këngët popullore këngëtarë popullor i shpreh ndjenjet e veta fuqishëm me anë të personifikimeve, sepse natyrës së qetë, kafshëve dhe trupave qiellorë u ka dhënë fuqinë e të folurit, vetëdijen dhe vullnetin për të kryer (bërë) veprime njerëzore dhe t'i ndjejnë gjëzimet dhe vuajtjet njerëzore. Në këtë mënyrë fiton bukurinë e vet dhe bëhet gjithëpërfshirës në zhvillimin e figurave poetike. Personifikime mjafët të qëlluara gjëjmë edhe në ciklin e Veriut, në këngët e vjetra legjendare, në këngët e LANÇ-së etj. Kështu p.sh. në rapsodinë Martesa e Halilit, dhitë, hëna, zogu etj. marrin pjesë aktive në veprimet e Halilit dhe e ndihmojnë atë. Kjo figurë mjafët dendur ndeshet edhe te poetët e Rilindjes dhe të Pavarësisë, si te Naimi, De Rada, Çajupi, Noli, Mjeda, Migjeni dhe te poezitë e poemat e Ll. Siliqit, D. Agollit, I. Kadaresë, F. Arapit etj.

Lulet të dinin,  
mike, sa të dua,  
këtu do të vinin  
të qajnë me mua.

zoqtë të dëgjonin,  
do t’më rrinin pranë  
dhe do të këndonin  
të harroj sevdanë.

(Çajupi, Dashuria D1, f. 45, Vepra, Beograd, 1963)

Nata shkon kaluar mbi kurriz të maleve  
(Fatos Arapi, Alarme të përgjakura)

“...Fshiu lot dhe më tha Tomorri:  
O shqiptarët e gjorë  
Dëgjoni Baba Tomorrë...”  
(Çajupi, Baba Tomorri)

Në këtë poesi kemi personifikimin e natyrës, gjegjësisht malin e Tomorrit që flet sikur të ishte i gjallë.

Mbi pesonifikimin jan bazuar përrallat popullore mbi kafshët, në të cilat kafshët, zogjtë, peshqit, përfytyrohen si qenie të ndërgjegjishme. Ato flasin me njëra-tjetren, merren vesh, shfaqin mendimet dhe ndjenjet e tyre. Kështu p.sh. në fabulën Të dy qetë dhe ujku të Naim Frashërit, ujku, pasi vërejti se të dy qetë ishin bashkuar (lidhur) mesveti për ta lufuar atë, i thotë në një anë njërit ka:

...Ty fort të dua,  
Se t’ët atë e kish mik,  
Ti pse më bije? Po shko mblidh mënt,  
Pse treghesh i lik?  
Ty s’të ngas, Zoti, a, mos e dhëntë!  
(Çajupi, Të dy qetë dhe ujku(fragment)

Propopeja (gr. prósōpon – person + poiéō – bëj) është një lloj personifikimi në të cilin poetët sendet e pajetë i paraqesin si të gjalla:

U ngrit fat’i Shqipërisë,  
si vdekuri nga varri,  
mori udhën’ e Azisë,  
duke ikur si marri.  
(Naim Frashëri, Histori e Skënderbeut, k.V, f.111, Poezi,)

Analizohen figurat letrare në shembuj

**R□Punë e pavarur**

Nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur ushtrimet në Fletore pune,fq.64

**LIDHJA ME FUSHAT E TJERA:**

Letërsi,arte

**VLERËSIMI:**

Vlerësim i vazdueshëm

**DETÝRË SHTËPIE : punë e diferencuar**

Fusha e kurrikulës- Gjuhë dhe komunikim

Shkalla e Kurrikulës/3/Klasa : VII

Lënda : Gjuhë shqipe

Tema mësimore: Sinekdoka

**Materiale dhe mjete mësimore**

Teksti mësimor *Gjuha shqipe 7*, fjalorë,tekste të ndryshme

**Metoda dhe teknika**

**mësimore.**

*Diskutim, leksion, shqyrtimi kategorizues, punë e pavarur*

**Përdorimi i teknologjisë informative :**

**Kontributi në kompetencat kryesore :**

1	<b>Kompetenca komunikim dhe të shprehur -- Komunikues efektiv</b>	1,2,3,4,5,6,7,8
2	<b>Kompetenca të të menduarit -- Mendimtar kreativ dhe kritik</b>	1,2,3,4,5,6,7,8
3	<b>Kompetenca të të mësuarit për të nxënë- Nxënës i suksesshëm</b>	1,2,3,4,5,6,7
4	<b>Kompetenca për jetë, punë dhe mjedis - Kontribues produktiv</b>	1,2,3,4,5,6,7,8
5	<b>Kompetenca personale - Individ i shëndoshë</b>	1,2,3,4,5,6,7,8,9,10
6	<b>Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm</b>	1,2,3,4,5,6,7,8

Fjalët kyçë: sinekdoka, figurë stilistike

**Rezultatet e të nxënëtit.**

**Njohuri gjuhësore:** Aftësi komunikuese

-Drejtohen dhe shprehen në mënyrë adekuate nëpërmjet gjuhës së folur dhe të shkruar

**Shkathësi :** Të zgjidhurit e problemeve

-Gjykojnë në mënyrë kritike dhe janë kreativë

**Sjellje:**

Puna grupore,

**Qëndrime :**

Vetëvlerësimi

**Vlera:**

Puna grupore, Kreativiteti, Të menduarit kritik

**Shprehi :**

Të lexuarit, Të shkruarit

**Kriteret e suksesit-Rezultate**

Nxënësi/ja:

- njeh sinekdokën si figurë stilistike
- analizon kuptimin e sinekdokës si në tekst
- kupton rëndësinë e përdorimit të figurave stilistike
- përdor sinekdokën gjatë komunikimit

## ZHVILLIMI I MËSIMIT

### **E □ Diskutim**

Mësuesi/ja organizon mësimin me pyetje për figurat stilistike të mësuara nga orët e kaluara

### **R □ Leksion/Shqyrtimi kategorizues**

Mësuesi/ja fillon mësimin duke prezantuar pjesën e tekstit,

Sinekdoka ( gr. synekdoke – nga syn – bashkë dhe ekdehomai – kuptoj, marr vesh) – është një lloj i veçantë i metonimisë Sinekdoka krijohet krijohet kur përdorim një fjalë për të shfaqur një ide më të gjërë ose më të ngushtë se ideja që duam ta shfaqim, kur përdorim numrin njëjës në vend të numrit shumës, të tërën në vend të pjesës, pjesën në vend të tërës, gjininë në vend të llojit ose lëndën prej së cilës përbëhet sendi në vend të sendit vetë: kryet në vend të njeriu, mbrojtje në vend të mbrojtësit; Migjenët në vend të poetë si Migjeni, Shqiptari kurdoherë me gjak e ka mbrojtur lirinënë vend të Shqiptarët...Bota u çudit me punët...në vend të njerëzimi..., sivjet patëm të korra të mira në vend të gjatë stinës së verës etj. Sa më pa i qeshi fytyra – u gëzua; gjëja e gjallë – lopët, delet etj. rregulloi qelqurinat – enët prej qelqi etj.  
 Shqipërinë e mori turku  
 i vu zjarr,  
 shqipëtar, mos rri po duku,  
 shqipëtar.  
 (Çajupi)

Analizohen figurat letrare në shembuj

### **R □ Punë e pavarur**

Nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur ushtrimet në Fletore pune.

<b>LIDHJA ME FUSHAT E TJERA:</b> Letërsi, arte	<b>VLERËSIMI:</b> Vlerësim i vazhdueshëm
<b>DETÝRË SHTËPIE :</b> <b>punë e diferençuar</b>	

Fusha e kurrikulës- Gjuhë dhe komunikim Shkalla e Kurrikulës/3/Klasa : VII Lënda : Gjuhë shqipe	Tema mësimore: Aliteracioni
<b><u>Materiale dhe mjete mësimore</u></b> Teksti mësimor <i>Gjuha shqipe 7</i> , fjalorë, tekste të ndryshme	<b><u>Metoda dhe teknika mësimore.</u></b> <i>Diskutim, leksion, shqyrtimi kategorizues, punë e pavarur</i>
<b>Përdorimi i teknologjisë informative :</b>	

**Kontributi në kompetencat kryesore :**

1	<b>Kompetenca komunikim dhe të shprehur -- Komunikues efektiv</b>	1,2,3,4,5,6,7,8
2	<b>Kompetenca të të menduarit -- Mendimtar kreativ dhe kritik</b>	1,2,3,4,5,6,7,8
3	<b>Kompetenca të të mësuarit për të nxënës - Nxënës i suksesshëm</b>	1,2,3,4,5,6,7
4	<b>Kompetenca për jetë, punë dhe mjedis - Kontribues produktiv</b>	1,2,3,4,5,6,7,8
5	<b>Kompetenca personale - Individ i shëndoshë</b>	1,2,3,4,5,6,7,8,9,10
6	<b>Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm</b>	1,2,3,4,5,6,7,8

Fjalët kyçë: Aliteracioni, figurë stilistike,

**Rezultatet e të nxënës**

**Njohuri gjuhësore:** Aftësi komunikuese

-Drejtohen dhe shprehen në mënyrë adekuate nëpërmjet gjuhës së folur dhe të shkruar

**Shkathësi :** Të zgjidhurit e problemeve

-Gjykojnë në mënyrë kritike dhe janë kreativë

**Sjellje:**

Puna grupore,

**Qëndrime :**

Vetëvlerësimi

**Vlera:**

Puna grupore, Kreativiteti, Të menduarit kritik

**Shprehi :**

Të lexuarit, Të shkruarit

**Kriteret e suksesit-Rezultate**

Nxënësi/ja:

